

RAPORT VJETOR | 2019

AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)



Bulevardi Dëshmorët e Kombit , Kryeministria, Kati III, Tiranë, Shqipëri
tel: +355(0)42251001 | email info@aida.gov.al | web: aida.gov.al

RAPORTI VJETOR 2019

1

Mesazh i Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s

2

Profili i AIDA-s

3

AIDA në ushtrim të funksioneve të veta

4

Marketing dhe Kërkim Analizë

5

Koordinimi i AIDA-s

6

AIDA në aktivitete dhe panaire

7

AIDA në përmbushje të transparencës
dhe rritjes së imazhit ndërinstitucional

1 MESAZH I DREJTORIT EKZEKUTIV



Z. Sokol NANO
Drejt看 Ekzekutiv

"Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) konsiderohet si pikë kyçe në nxitjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në vend, si promotore e zhvillimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe si një entitet i fortë stimulues për produktet Made in Albania.

AIDA, konceptuar si një strukturë bërthamë, është një partner i përkushtuar për përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve në Shqipëri, si dhe rritjen e mundësive për investim dhe zhvillim të sektorëve prioritarë në vend.

Ne synojmë zhvillimin e një strukture dinamike të orientuar drejt ofrimit të shërbimeve profesionale One Stop Shop ndaj investorëve vendas dhe të huaj, të cilët duan të investojnë kapitalin e tyre në Shqipëri.

Gjithashtu ne do të vijojmë të mbështesim zhvillimin e biznesit shqiptar, për ta bërë atë më konkurrues në tregun vendas dhe në veçanti në tregun e huaj, nëpërmjet zhvillimit të ideve të reja në biznes si dhe nxitjes së inovacionit.

Suksesi i AIDA-s në përmbushjen e misionit të saj lidhet ngushtë me konsolidimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me agjencitë homologe, organizatat dhe institucionet lokale e qendrore.

Ne jemi mbështetja që ju duhet në vendimin tuaj për të investuar, për të zhvilluar biznesin tuaj dhe për të konkurruar në treg.



invest in Albania

2 PROFILI I AIDA-S

2.1. Misioni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka për mision të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, të forcojë potencialin eksportues të vendit, të promovojë mbështetjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit. AIDA, maksimizon investimet e brendshme dhe të huaja, nëpërmjet krijimit të iniciativave ndihmuese rrit aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri, përmirëson kapacitetet teknologjike dhe rinovimin e tyre me qëllimet e kombinuara që të rris investimet e huaja direkte, të forcojë kapacitetet e biznesit Shqiptar, si edhe të ndërtojë një imazh të denjë të Shqipërisë me fokus tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

2.2. Funksionet kryesore të AIDA-s

Veprimtaria e Agjencisë përqëndrohet, kryesisht, në:

- lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë;
- rritjen e aftësisë konkurruese dhe inovative të ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve;
- nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja.

Agjencia ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si edhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore.

2.3. Kuadri ligjor i Agjencisë

AIDA funksionon në bazë të kuadrit ligjor të posaçëm:

- Ligjit Nr.10 303, datë 15.7.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve",
- Statutit të AIDA-s, miratuar me Vendim të Bordit Drejtues të AIDA-s Nr. 2, datë 04.01.2011, të ndryshuar me vendimin nr. 1 datë 25.03.2019,
- Rregullores së Brendshme të AIDA-s, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s Nr. 11, datë 21.07.2011;
- Vendimit nr. 3 datë 17.06.2019 "Për miratimin e nivelit të pagave dhe të strukturës e organikës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Aktualisht AIDA strukturohet në pesë drejtori:

1. Drejtoria e Investimeve


2. Drejtoria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Projekteve

3. Drejtoria e Marketing & Kërkim Analizë

4. Drejtoria e Koordinimit

5. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

2.4. Organigrama



Drejtoria e Investimeve ka këto funksione:

- a) asiston dhe mbështet investimet e drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime;
- b) ofron shërbimin e përkujdesjes dhe mbështetjes të investitorëve ekzistues ose potencialë;
- c) asiston dhe mbështet me procedura të përshpejtuara investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.

Drejtoria e NVM dhe Projekte ka këto funksione:

- a) të rrisë aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare për zhvillimin e tyre;
- b) të jetë në shërbim të sipërmarrësve shqiptarë dhe partnerëve të huaj që dëshirojnë të hyjnë në partneritet me kompani shqiptare nëpërmjet shërbimeve kryesore siç është dhënia e granteve të shtetit shqiptar apo identifikimi i tregjeve ose partnerëve të rinj për eksport, nevojat për trajnim dhe për certifikim produkti, lehtësimin e pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare etj, mbështetje nëpërmjet projekteve të ndryshme me donatorë.

Drejtoria Marketing & Kërkim Analizë ka këto funksione:

- a) Sigurimin e komunikimit dhe marketingut të institucionit për politikat, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj.
- b) Kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.

Drejtoria e Koordinimit ka këto funksione:

- a) Mbajtjen dhe koordinimin e marrëdhënieve institucionale me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me departamentet brenda AIDA-s.
- b) Matjen dhe vlerësimin e rezultateve të performancës së institucionit me qëllim orientimin e politikave dhe burimeve.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka këto funksione:

- a) Të mbështesë veprimtarinë e Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin e veprimtarisë normale të proceseve të punës,
- b) Të ndjekë të gjithë aktivitetin ekonomik – financiar dhe administrativ të institucionit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3 AIDA NË USHTRIM TË FUNKSIONEVE TË VETA

3.1. Hyrje

AIDA, ju ndihmon të investoni në Shqipëri duke ju mbështetur me:

Informacione mbi mundësitë e investimit në Shqipëri dhe arsyet kryesore përse vendi ynë është tërheqës për Investimet e Huaja Direkte. Të gjithë informacionin rreth ekonomisë së Shqipërisë, burimet njerëzore, infrastrukturës, stimujve investues prezantohen në një shkallë të gjerë me dokumente në shqip dhe anglisht;

Kontakte nga Shqipëria apo jashtë saj, falë një pune paraprake anketimi dhe misionëve specifikë të kontaktit për të përmbushur nevojat e investorëve. Qasja jonë është të paraqesim ofertën më të kënaqshme shqiptare për kompanitë që kërkojnë ndërkombëtarizim;

Këshilla për mjedisin e përshtatshëm për suksesin e projekteve, rajoneve të funksionimit, planeve të investimeve, metodave të financimit;

Ndihmë për investorët me vizitat eksploruese në Shqipëri dhe në fazat e ndryshme të zbatimit të projektit. Programet e kontaktit me institucionet dhe kompanitë shqiptare në fushat e aktiviteteve të dëshiruara dhe interesave të investorëve, të cilat përgatiten nga stafi i AIDAs;

Mbështetje për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kompanisë përmes monitorimit të personalizuar dhe ndihmës së vazhdueshme me departamentet e ndryshme ministrore shqiptare, si dhe me organizatat dhe autoritetet rajonale.

3.2. Investimet

3.2.1 Investimet e huaja direkte (IHD)

3.2.1.1. Krahasim i vitit 2018 – 2019 në terma të fluksit dhe stokut të IHD

Referuar të dhënave aktuale nga burime të

Bankës së Shqipërisë, trendi i IHD-ve në vend, në terma të fluksit dhe stokut të tyre, është rritës dhe premtues.

Fluksi i IHD-ve në vitin 2019 arriti në vlerën e 1,079 milionë Euro dhe është rritur me 59 milionë Euro (ose 5,78%) në krahasim me vitin paraardhës. Referuar të dhënave zyrtare të QKB, rezultoi se për vitin 2019 janë reregjistruar 1435 kompani të reja me kapital të huaj dhe të përbashkët të cilat janë aktive dhe operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare. Krahasuar me vitin paraardhës kemi një rritje me 12,72%. Për vitin 2018 vlera e kompanive të reregjistruara ishte 1273 dhe përbëhej në masën 83,2% nga kompani me kapital 100% të huaj dhe 16,8% nga kompani me kapital të përbashkët (shqiptar dhe të huaj). Për vitin 2019, për kompanitë e reja të regjistruara, kjo ndarje paraqitet në raportin 83,3% kompani me kapital 100% të huaj dhe 16,7% me kapital të përbashkët.

FLUKSI I IHD-VE




Burimi: Banka e Shqipërisë

Vlera e stokut për vitin 2019 shënon shifrën 8,542 milionë Euro dhe është rritur me 939 milionë Euro (ose 12,35%) në krahasim me vitin e mëparshëm.

3.2.1.2. Vështrim krahasues i Fluksit dhe Stokut për periudhën 2014-2019


Grafikët në vijim paraqesin nivelin e stokut dhe fluksit të IHD-ve për periudhën 2014-2019.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Nga grafiku i mësipërm vërejmë se stoku i IHD-ve ka patur një trend rritës përgjatë periudhës 2014-2019 duke shënuar vlerën më të lartë në vitin 2019.

Në vitin 2018 krahasuar me vitin paraardhës stoku është rritur me 1,147 milionë Euro ose me 17,76%. Kjo tendencë rritëse ka vijuar edhe në vitin 2019 ku stoku ka arritur vlerën 8,542 milionë Euro, duke shënuar një rritje me 939 milionë Euro ose 12,35%.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku i mësipërm paraqet ecurinë e fluksit të IHD-ve përgjatë periudhës 2014-2019. Vërehet një tendencë e qëndrueshme dhe pozitive e vlerës së fluksit përgjatë viteve. Në vitin 2018 krahasuar me vitin paraardhës vlera e fluksit është rritur me 121 milionë Euro ose 13,45%. Rritja ka vijuar edhe përgjatë vitit 2019, duke shënuar vlerën 1079 milionë Euro, më e larta nga viti 2014.

3.2.1.3. Fluksi dhe Stoku i IHD sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2018 dhe 2019

Duke bërë një analizë të shpërndarjes së fluksit të investimeve direkte sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2018, aktiviteti kryesor që ka zënë peshën më të madhe të fluksit për vitin 2018 është energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë me 44,41% të totalit. Edhe përgjatë vitit 2019 vijon të dominojë ky aktivitet me 30,95% të totalit të fluksit.

Aktivitete të tjera dominuese përgjatë vitit 2018 kanë qenë: industria nxjerrëse (17,35%); aktivitete të pasurive të paluajtshme (11,08%) dhe aktivitete financiare dhe të sigurimit (9,41%). Këto aktivitete kanë vijuar të mbizotërojnë edhe përgjatë vitit 2019 ku industria nxjerrëse vijon të mbetet e dyta me 20,30% të totalit dhe pas saj vijnë aktivitetet financiare dhe të sigurimit me 11,58% dhe aktivitetet e pasurive të paluajtshme me 10,66%.

Duke bërë një analizë të shpërndarjes së stokut të investimeve direkte sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2018, referuar gjithnjë të dhënave të Bankës së Shqipërisë, shihet se përgjatë vitit 2018 sektorët dominues kanë qenë energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar me 27,03%; informacioni dhe komunikacioni 14,57%; aktivitete financiare dhe të sigurimit 14,2% dhe industria nxjerrëse 14,1%.

Këto aktivitete kanë vijuar të dominojnë edhe përgjatë vitit 2019, respektivisht energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar 28,3%; Industria nxjerrëse 14,39%; Informacioni dhe komunikacioni 13,05% dhe aktivitete financiare dhe të sigurimit 12,69%.

3.2.2. Lead generation and AfterCare

AIDA, ka një rol kryesor në tërheqjen dhe rritjen e investimeve në Shqipëri. Në këtë kontekst, agjencia lehtëson dhe mbështet investimet e drejtpërdrejta në Shqipëri, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke i ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues ose potencial.

Në kuadër të përmbushjes së objektivave kryesore për investimet këtë vit AIDA është fokusuar në drejtim të:

Tërheqjes dhe mbështetjes së investimeve e drejtpërdrejta, nëpërmjet ofrimit të asistencës dhe shërbimeve;

- Identifikimit dhe promovimit të mundësive të investimeve në Shqipëri, si dhe zhvillimit të veprimtarive në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë, në nivel ndërkom-bëtar;
- Konsolidimin e pozicionit të Agjencisë si pikë qendrore për të gjitha nevojat e investorëve potencialë dhe atyre ekzistues, në kuadër të projekteve të investimeve.

3.2.2.1. Përthithja e investimeve të huaja në Shqipëri duke reflektuar një qasje proaktive ndaj investorëve nëpërmjet organizmit të “Investor Outreach Campaigns”

Në kuadër të nismës “Agriculture Outreach Campaign”, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe International Finance Corporation (IFC), ka realizuar fushatën e parë për tërheqjen e investimeve në sektorin e bujqësisë në Maj 2019, në bashkëpunim me Ambasadën e Shqipërisë në Zvicër. Kjo nismë synon nxitjen e investimeve të huaja në sektorin e bujqësisë, që rezulton si sektori me përqendrimin më të ulët të investimeve.

Si sektor i dytë prioritar për tërheqjen e investimeve të huaja dhe organizimin e fushatave të outreach është përzgjedhur sektori automotiv, duke synuar rritjen e shumëllojshmërisë së investimeve të huaja, një ngjitje më të shpejtë në zinxhirin e vlerës, si dhe një prezencë më të madhe të Shqipërisë në këtë sektor.

Së bashku me Bankën Botërore është përcaktuar një plan veprimi mbi organizimin e fushatës outreach në sektorin automotiv si dhe është trajnuar stafi i AIDA-s me konceptet “Western Balkans Regional Investment Promotion and Outreach Campaign”. Pas një analize të mirëfilltë është përzgjedhur Austria si target Shtet prioritar për realizimin e kësaj fushate.

Nëpërmjet Bankës Botërore është mundësuar akses në faqen “Factiva”, të dhënat e së cilës kanë shërbyer në procesin e targetimit të 200 kompanive, identifikimin e selive qendrore dhe vendimmarrësve të kompanive austriake.


Është hartuar prezantimi i value proposition dhe një oferte konkrete për sektorin automotiv në Shqipëri. Janë përpiluar dhe dërguar 182 letra zyrtare për realizimin e takimeve në selitë e tyre dhe komunikimi i ofertës zyrtare.

3.2.2.2. Gjenerimi i Leads, ndjekja dhe follow up i tyre

AIDA, vazhdimisht asiston kompanitë e interesuara duke u mundësuar informacion të përditësuar mbi klimën e biznesit në Shqipëri, sistemin e taksave, lehtësirat që ofrohen për investorët e huaj, kuadrin ligjor për investimet, mundësitë për partneritete me biznese vendase, etj.

Në përfundim të vitit 2019 u arrit numri i 13 projekteve “Lead” në ndjekje. Shtetet e tyre të origjinës janë kryesisht Italia dhe Gjermania, ndjekur nga kompani greke, izraelite, koreane dhe japoneze, të cilat kanë shprehur interesin për realizimin e investimeve në Shqipëri. Vlera totale e këtyre investimeve arrin përafërsisht 470 milionë Euro, ndërsa parashikohet që numri i të punësuarve në këto aktivitete të jetë mbi 4400.

Për sa u përket fushave të aktivitetit të këtyre projekteve, interesi kryesor ka qenë në sektorët e manifakturës, industrisë automotiv, si dhe industrisë nxjerrëse dhe përpunuese.



3.2.2.3. Suksese në gjenerimin e investimeve

Që prej hapave të parë të krijimit të biznesit në Shqipëri, AIDA ka ofruar me sukses asistencë ndaj investimeve të rëndësishme të ardhura rishtazi në sektorin automotive në dy vitet e fundit, kompani, të cilat kanë zgjeruar aktivitetin në terma investimi si dhe numër punonjësish edhe përgjatë vitit 2019, të tilla si:

- Giobert,
- Delmon,
- Rework (B-810),
- Yura Corporation,
- Sumitomo Group (Sews-Cabind),

Duke iu referuar vitit 2019 është shënuar një rritje kërkesash në sektorin automotiv, jo vetëm nga kompani prestigjioze nga Evropa Perëndimore, por dhe nga tregu aziatik.

3.2.2.4. Formalizmi i bashkëpunimit me Bashkitë, realizimi i vizitave në kompani, asistencë ndaj këtyre kompanive dhe raportimi i rezultateve

AIDA ka një rol proaktiv ndaj përqasjes së investorëve të huaj të pranishëm në Shqipëri. Në kuadër të një Plani Veprimi të përpiluar për vitin 2018-2019, AIDA është përfshirë në krijimin e një rrjeti efektiv komunikimi e bashkëpunimi të ngushtë me aktorë të rëndësishëm në nivel lokal dhe qendror, në funksion të nxitjes së riinvestimeve në vend.

Në këtë kuadër, AIDA ka institucionalizuar bashkëpunimin me qeverisjen lokale, për të qenë në sinergji të përbashkët kundrejt përmirësimit të shërbimit të investorëve të huaj të pranishëm dhe gjenerimin e investorëve të rinj. Me asistencën e IFC/Banka Botërore, AIDA ka zhvilluar një mekanizëm mjaft efektiv në organizimin e vizitave pranë bizneseve ashtu si dhe në zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të investorëve në Shqipëri.

Ky rrjet është riaktivizuar për të dytin vit radhazi në bashkëpunim me 8 (tetë) bashkitë kryesore të vendit: Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier dhe Elbasan. Takimet kanë mundur të identifikojnë problematikat që hasin investi-

-torët e huaj dhe vendas, duke siguruar kështu zgjidhjen e tyre në një kohë sa më të shkurtër. Këto takime kanë konsoliduar raportin mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke pasur në vëmendje investorët ekzistues dhe sidomos nxitjen e ri-investimeve.

Nga puna e një viti ka rezultuar se:

- 9 kompani – kërkojnë të bëjnë riinvestim në fabrika të reja me një vlerë totale prej 1,037,718.94 Euro
- 8 kompani – synojnë zgjerim të linjës së prodhimit me një vlerë totale investimi prej 1,047,604.34 Euro
- 6 kompani – kanë rritur numrin total të punëtorëve me 1800 punëtorë të rinj.
- Ndërkohë, shqetësimet e subjekteve për vitin e kaluar rezultojnë si më poshtë:
- 10 kompani kanë hasur probleme sa i përket aksesit në financë dhe janë orientuar mbi mundësinë e aplikimit në fondet e AIDA-s.
- 9 kompani ngritën shqetësime që lidhen me qeverisjen vendore (infrastrukturë, menaxhim mbetjesh, linjat e transportit, regjistrim pronësie etj) për të cilat po bashkëpunohet me Bashkitë përkatëse për zgjidhjen e tyre.
- 4 kompani janë përballur me shqetësimin e ndryshimit të skemës së rimbursimit të TVSH-së (diferencën 14% në shitblerjen e mallrave) dhe ky problem është deleguar si propozim për reformë.
- 1 kompani po asistohet për zgjerimin e numrit të punonjësve.
- 2 kompani po asistohen për zgjerimin dhe identifikimin e pronës.

Realizimi i vizitave në kompanitë e targetuara kanë për qëllim:

- të përcaktojnë potencialet premtuese për zhvillimin e riinvestimeve,
- të vlerësojnë nevojat e investorëve në lidhje me shërbimet e ofruara ndaj biznesit
- të identifikojnë sfidat kryesore që lidhen me projektet e investimeve në Shqipëri në sektorë të ndryshëm,
- mbledhjen e informacionit për krijimin e një oferte konkrete në sektorin automotiv me qëllim tërheqjen e investorëve të rinj.

3.2.2.5. Suksese në kuadër të shërbimit Aftercare:

Përgjatë vitit 2019 Sektori AfterCare ka pasur disa histori suksesi, sa i përket asistencës së dhënë për kompanitë dhe investitorët ekzistues që operojnë në Shqipëri. Kompani si Delmon, SV Mega, Yura Corporation, Forchner, Innova-way, Giobert, Rework, DBS Group, Mabel International, etj janë vetëm disa nga shembujt e mirë të efikasitetit të asistencës së dhënë nga AIDA dhe ndjekjes hap pas hapi të realizimit me sukses të planit të biznesit të investitorëve dhe gjenerimit të ri investimeve.

Aftercare përgjatë 2019 duke e krahasuar me 2018, e gjeti AIDA-n më proaktive ndaj përqasjes së investitorëve të huaj në vend. Duke bërë një krahasim për sa i përket vizitave dhe asistencës së ofruar nga AIDA në dy vitet e fundit:

Viti	2018	2019
Kompani të vizituara	27	60
Kompani të asistuar	14	31
Problematika të zgjidhura	13	28

Shërbimi i Aftercare gjatë 2019 ka dyfishuar numrin e vizitave dhe asistencën ndaj investitorëve prezentë krahasuar me një vit më parë.

3.2.2.6. Databaza e Pronave


Databaza e pronave është pasuruar duke shtuar informacione të reja për sa i përket pronave shtetërore që ekzistojnë dhe gjithashtu duke shtuar me prona të reja shtetërore dhe private në databazë.

Sektori është vendosur në kontakt të drejtpërdrejtë me administratorët e këtyre pronave dhe ka siguruar materiale të reja hartografike për disa nga pronat. Gjithashtu, janë siguruar foto të objekteve gjatë vizitave në terren të këtyre pronave.

3.2.3. Tregu i punës

3.2.3.1. Indikatorët e tregut të punës

Forca e punës gjatë periudhës 2017-2019 ka qenë në rritje. Në vitin 2018 forca e punës ishte 1403 mijë persona, ndërsa ka arritur në 1430 mijë në 2019 me një rritje prej 3,2%.



Niveli i punësimit përgjatë periudhës 2017-2019 ka shfaqur gjithashtu rritje. Në vitin 2019 niveli i punësimit arriti në 1266 mijë të punësuar, duke u rritur me 2,9% nga viti para-ardhës. Rrjedhimisht kemi ulje të nivelit të papunësisë me një rënie prej 0.8 pikë përqindje nga viti 2018 në vitin 2019, duke arritur nivelin e 165 mijë të papunëve (për grup-moshën 15-74 vjeç).

Ulja më domethënëse e shkallës së papunësisë vihet re në grupmoshën 15-24 vjeç. Ndërkohë vihet re ende hendeuku gjinor në punësim.

Shkalla e papunësisë në %

Mosha	2017	2018	2019
15-24 vjeç	31.9	28.3	27.2
25-54 vjeç	12.6	11.2	10.6

Forca punëtore në mijë

	2017		2018		2019	
Forca e Punës	1.385		1.403		1.430	
Meshkuj / Femra	57.4 %	42.6 %	56.3 %	43.7 %	55.6%	44.4%
Të punësuar	1.195		1.230		1.266	
Meshkuj / Femra	56.8 %	43.2 %	56.1 %	43.9 %	55.5%	44.5%
Të papunë	190		173		165	
Meshkuj / Femra	61 %	39 %	57.7 %	42.3 %	56%	44%

3.2.3.2. Punësimi sipas aktivitetit ekonomik


Për sa i përket punësimit sipas aktiviteteve ekonomike në vitin 2019, sektori i shërbimeve (shërbime të tregut dhe shërbime jo të tregut) dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 43,5 % dhe 36,4 % të të punësuarve gjithsej.

Punësimi sipas aktivitetit ekonomik (në %)

Viti	2017	2018	2019
Bujqësi	38.2	37.4	36.4
Shërbime të tregut	25	25.7	27.2
Shërbime jo të tregut	17.4	17.2	16.3


Burimi: INSTAT

Viti 2019 karakterizohet nga një rritje e punësimit në sektorin e shërbimeve të tregut dhe manufakturës, rritje e numrit të të punësuarve me pagë dhe ulje e numrit të të vetëpunësuarve. Tregu shqiptar i punës është ende jo mikpritës i profesioneve të lira, të cilat shpesh shndërrohen në biznese familjare me punëtorë familjarë të pa paguar.



3.2.3.3. Punësimi sipas statusit në punësim.

Sipas vlerësimeve të anketës për vitin 2019, rezulton se 45,7 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 32,3 % janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 22 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.



Paga minimale

Paga minimale është nga ata indikatorë të tregut të punës me dy impakte direkte: është indikator që tërheq interesin e investitorëve të huaj por njëkohësisht përcakton edhe standardin e investimit potencial të huaj.

Viti	2016	2017	2018	2019
Paga Minimale	22.000	24.000	24.000	26.000

Paga mesatare


Në vitin 2019, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 52.380 lekë. Niveli i pagës mesatare mujore bruto paraqet një tendencë në rritje. Krahasuar me vitin 2018, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 3,5 %.

Viti	2017	2018	2019
Paga mesatare mujore bruto	48.967	50.589	52.38
Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror	59.813	61.023	63.084
Paga mesatare mujore në sektorin privat	44.027	45.759	47.532



3.2.4. Tregtia e jashtme

3.2.4.1. Eksportet




Në vitin 2019 vlera e eksporteve ishte 2,429 (milion Euro), duke shënuar një rënie me 3,7% krahasuar me vitin 2018 ku totali i eksporteve arriti shifrën 2,524 (milionë Euro).

Edhe përgjatë vitit 2019 vijnë të dominojnë grup-mallrat "tekstile dhe këpucë" me 40%, "minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" (17%) dhe "materiale ndërtimi dhe metale" (15%).

3.2.4.2. Importet

Importet 2019



Në vitin 2019 totali i importeve arriti shifrën 5,277 (milionë Euro), duke shënuar një rritje prej 1,2% krahasuar me vitin paraardhës. Grup-mallrat dominues përgjatë vitit 2019 kanë qenë:

- "makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" (21% e totalit të importeve);
- "ushqim, pije, duhan" (17%);
- "produkte kimike dhe plastike" (14%); dhe
- "tekstile, këpucë" me 13% te totalit.


Rritja e importeve në këtë drejtim përbën një tjetër indikator se në cilët sektorë duhet të fokusohet Qeveria Shqiptare në promovim, sipas një plani afatgjatë.

3.3. Investimet strategjike

3.3.1. Hyrje

Më 24.12.2015 hyri në fuqi paketa e re ligjore për investimet strategjike, e cila mundëson ligjërisht që investimet vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjike sipas këtij ligji, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përsheptuara dhe favorizuese. Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/investitor strategjik
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS)
- Agjent asistues i investitorit strategjik



Referuar legjislacionit të investimeve strategjike, AIDA në cilësinë e One Stop Shop ka të gjithë autoritetin e nevojshëm për të pranuar dosjet, shqyrtuar, kontrolluar përputhshmërinë e aplikimeve, dhe më pas të koordinojë vendimmarrjen.

One Stop Shop kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjik (pra dy statuse të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planet kombëtare të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucionesh njëkohësisht).

One Stop Shop koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda 30 ditësh).

One stop shop përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.

Janë përgatitur nga One Stop Shop formatet standarde të raportimit teknik, me qëllim që Grupi Operacional të procedojë lehtësisht brenda afateve.

Duke qenë se procedurat kanë krijuar tashmë precedent, edhe mbledhjet për një projekt janë reduktuar. (Ligji 55/2015 parashikon që KIS ka 30 ditë pune afat për të marrë një vendim lidhur me një projekt investimi që i propozohet nga grupi operacional. Njëkohësisht sipas ligjit, KIS, pasi aprovon statusin strategjik, duhet të miratojë dhe planin e veprimit (masat shtetërore) për projektin në shqyrtim. Formatet e përgatitura janë të konceptuara në mënyrë të tillë që secili përfaqësues i grupit operacional të japë kontribut njëkohësisht jo vetëm për vlerësimin teknik të projektit por dhe për planin e veprimit mbi masat shtetërore që vlerësohen (sipas kompetencës) se duhet t'i jepen projektit. Në këtë rast, Sekretariati Teknik paraqitet në KIS me dy materiale njëherazi: raport të vlerësimit teknik dhe plan veprimi. Afati 30 ditor shfrytëzohet për të zbardhur vendimin dhe rekomandime shtesë të KIS).

3.3.2. Projektet të vleresuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë vitit 2018 dhe 2019

Projekte të shqyrtuara nga AIDA 2018- 2019

Viti	2018	2019	Totali
Projekte Totale	5	8	13
Projekte të Miratuara	3	5	8
Projekte të Refuzuar	2	3	5

3.3.3. Projektet sipas sektorëve strategjikë


Projektet e shqyrtuara përgjatë vitit 2019 i përkasin sektorëve të ndryshëm strategjikë të parashikuar nga legjislacioni i investimeve strategjike.

Sektori i Turizmit ka numrin më të madh të projekteve të investimit, duke u ndjekur më pas nga sektori i Bujqësisë dhe Zonave me Përparësi Zhvillimi.

Ndërkohë, referuar të dhënave të projekteve sipas sektorëve strategjikë për vitin 2018 rezulton se sektori i Bujqësisë ka numrin më të madh të projekteve të investimit duke u ndjekur më pas nga sektori i Energjisë & Peshkimit.

Viti	2018	2019
Totali	5	8
Energji dhe miniera	2	-
Turizëm	-	6
Bujqësi dhe peshkim	3	1
Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik	-	1

E shprehur në formë grafike:
Projektet sipas sektorëve



- Energji dhe miniera
- Turizëm
- Bujqësi dhe peshkim
- Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

Nëse analizojmë më konkretisht numrin e projekteve sipas sektorëve, më poshtë evidentohe projektet në sektorët strategjikë të shpërndarë përgjatë këtyre dy viteve.

Në vitin 2018 janë shqyrtuar:

- 3 projekte në sektorin e Bujqësisë
- 2 projekte në sektorin e Energjisë

Në vitin 2019 janë shqyrtuar:

- 6 projekte në sektorin e Turizmit
- 1 projekt në sektorin e Bujqësisë dhe Peshkimit
- 1 projekt në sektorin e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik

Arsyet pse pjesa më e madhe e projekteve është e lidhur me fushën e turizmit është për shkak të miratimit të ligjit Nr. 93/2015 "Për Turizmin", pasi ligji parashikon një sërë lehtësirash për zhvillimin e investimeve.

Për më tepër, në zbatim të ligjit kanë dalë dhe një sërë VKM, të cilat e kanë bërë ligjin të aplikueshëm, konkretisht: VKM Nr.162, datë 02.03.2016; VKM Nr.691, datë 05.10.2016 "Miratimin e formatit të marrëveshjes me investitorët në fushën e turizmit"; Vendim Nr. 257, datë 9.5.2018 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të dokumentacionit për subjektet që aplikojnë për statusin "investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special"; VKM nr. 370, datë 29.5.2019 për disa shtesa në vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese".

Në nenet 33 e në vazhdim parashikohet roli i shtetit si zhvillues, përfshirja e tij në partneritete publiko – private, përfaqësimi me aksione në sipërmarrje turistike, vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme si dhe sigurimi i infrastrukturës mbështetëse. Një tjetër masë mbështetëse për zhvillimin e investimeve është ajo lidhur me zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, ku pasuritë e paluajtshme, në pronësi të shtetit kanë kaluar në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin. Si dhe pasuritë e paluajtshme, në administrim të njësive të qeverisjes vendore, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 2 muajve nga miratimi i zonës, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Këto pasuri vihen në dispozicion për projekte investuese në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, për një periudhë deri në 99 vjet, me miratim të Këshillit të Ministrave. Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore mund të bëhet edhe nëpërmjet kontratës simbolike 1 euro.

Në mbështetje të ligjit "Për investimet strategjike", në rastin e investitorëve me status Investitor Strategjik i Veçantë, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, rast pas rasti, transferimin e së drejtës së pronësisë të pasurive të paluajtshme shtetërore tek investitori privat, duke e kushtëzuar kalimin me realizimin e plotë të investimit.

Një parashikim tjetër i ligjit lidhet me të drejtën për përdorimin e brigjeve, parashikuar nga neni 40 i ligjit "Për turizmin", ku u njihet e drejta për projekte për të pasur në dispozicion një hapësirë të plazhit, në raport me kapacitetin e strukturës akomoduese.

Ligji për turizmin pësoi disa shtesa në vitin 2017 me ligjin Nr. 114/2017 në të cilin u parashikua dhënia e statusit special për subjektin që plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme: a) është investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, në Republikën e Shqipërisë; b) vlera e investimit është të paktën 8 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 yje dhe të paktën 15 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 5 yje.

Ndërkohë që në ligjin për Investimet Strategjike, nr. 55/2015, parashikohet që për marrjen e statusit strategjik vlerat për tu përmbushur janë më të larta, konkretisht: a) i barabartë ose më i madh se 5 000 000 (pesë milionë) euro, dhe që në të njëjtën kohë krijon, minimalisht, 80 vende të reja pune, për investitorët/projektet që do të përfitojnë statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar"; b) i barabartë ose më i madh se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, për investitorët / projektet që do të përfitojnë statusin "Investim /investitor strategjik, procedurë e veçantë".

Këto parashikime nuk shkaktojnë probleme në praktikë, pasi ligji nuk e ndalon investitorin të aplikojë në secilën prej këtyre procedurave dhe nuk janë konkurruese me njëra tjetrën, për aq kohë sa dhe kriteret dhe përfitimet nga këto dy ligje janë të ndryshme.

Lehtësira vihen re dhe në fushën fiskale, pasi me ndryshimet e pësura në legjislacion në vitin 2018, parashikohet:

- Norma e TVSH prej 6% për strukturat akomoduese (fjetje + mëngjes);
- 6% TVSH për çdo furnizim brenda strukturave "Hotel/Resort 5*, Status Special" (Brand Name);
- Përrjashtim nga taksa e ndërtesës dhe taksa e ndikimit Infrastrukturë Hotel/Resort 5*, Status Special" (Brand Name);

- Përfshirja nga tatim fitimi, për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, "hotel/resort 4* dhe 5*", status special" të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024.
- 6% tvsh për subjektet e certifikuar në agroturizëm (fjetje + restorant (pa pije)
- Përfshirja nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për operatorët agroturistikë që do të bëjnë investime në këtë fushë.
- Nga 1 janari 2018 për subjektet e certifikuar në agroturizëm tatim fitimi ulet nga 15% në 5%.

3.3.4. Rezultatet si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike

- Për projekte të cilat aplikojnë tek AIDA pasi kanë marrë leje zhvillimi dhe leje ndërtimi, masat mbështetëse janë lehtësisht të zbatueshme dhe me procedura të përsheptuara.
- Zbatimi i ligjit përgjatë periudhës 3 vjeçare ka krijuar një rrjet komunikimi ndër-institucional shumë funksional.
- Për herë të parë në janar 2020, në bazë të procedurave të LIS, u arrit që një institucion të aplikojë tek AIDA për të kërkuar ndihmën e institucioneve të tjera me qëllim hartimin e një projekti potencial strategjik.
- Përfshirja në ligj e zonave me prioritet zhvillimi, si një sektor strategjik, përbën një mekanizëm shumë efikas për të akomoduar investime me impakt të theksuar social dhe ekonomik për zona të veçanta.


3.3.5 Investitor i huaj strategjik: YURA CORPORATION

Kompania koreano-jugore Yura Corporation u themelua në qytetin e Fierit më 25 prill të 2018-ës me kapital 100% të huaj pas aplikimit për statusin e Investitorit Strategjik nëpërmjet AIDA-s. AIDA e ka nisur komunikimin duke asistuar kompaninë që prej janarit të 2017-ës, duke ndihmuar në të gjitha hapat për realizimin e ciklit të investimit në Shqipëri. Në vitin 2019 Yura Corporation nisi ndërtimin e stabilimentit për prodhimin e pjesëve të automobilave, me një investim prej 13 milionë euro, i cili nëpërmjet dy fazave të tij synon punësimin e rreth 1100 punonjësve dhe investim në gati 4.9 hektarë tokë në zonën e Fierit.

3.4. Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme


3.4.1. Hyrje

Drejtoria NVM dhe Projekteve pranë AIDA-së ka si objektiv të ofrojë shërbime për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, promovimit të bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve dhe të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja. Drejtoria ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) në Shqipëri luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare dhe zhvillimin e vendit, shprehur kjo nëpërmjet treguesve të punësimit në sektorin privat, si dhe në kontributin e të ardhurave kombëtare. Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT) numri i NVM-ve aktive në fund të vitit 2018 shënonte 107.269, që zënë 99.8 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive. Sektori i tregtisë ka peshën më të madhe të ndërmarrjeve NVM me 41,4 %, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 21,2 %. Përqindjen më të ulët e ka sektori i industrisë nxjerrëse dhe sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me nga 0,6 % secili.



Sa i përket punësimit, 79.8 % e të punësuarve janë të punësuar nga NVM-të. Pësja e tyre ka zbritur me rreth 0.5 pikë % krahasuar me një vit më parë, duke reflektuar një orientim të ekonomisë drejt sipërmarrjeve të mëdha. Sektori i tregtisë punëson 29 % të NVM-ve, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 19.5% dhe sektori i industrisë përpunuese me 18.4 %. Sektorët me numrin më të vogël të të punësuarve në NVM-të, janë sektori i industrisë nxjerrëse me 1.8 % dhe sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 2.3 %.

Punësimi sipas Sektorëve të Ekonomisë në %



Krahasuar me 2019, zëri ku shohim më shumë ndryshim janë **investimet vendase**. Në vitin 2018, 70.5 % e investimeve vendase janë bërë nga NVM-të, nga 60.1 % të kryera vitin e kaluar. Sektori me përqindjen më të lartë të investimeve të kryera në NVM-të është sektori i tregtisë me 24,3 %. Nga ana tjetër, sektori i transportit dhe komunikacionit ka përqindjen më të ulët të investimeve prej 4,3 %.

Tab.1 Treguesit kryesorë dhe struktura e tyre sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2018

	Ndërmarrje		Të punësuarit		Shitjet neto		Investimet		Vlera e shtuar	
	nr.	%	nr.	%	mln lekë	%	mln lekë	%	mln lekë	%
Madhësia ndërmarrjes										
Gjithsej	107,450	100	515,706	100	2,180,305	100	238,145	100	565,478	100
NVM (1-249 të punësuar)	107,269	99.8	411,727	80	1,688,620	77.5	168,104	70.5	390,588	69
Mikrondërmarrje	100,876	93.8	194,867	38	409,991	19	32,469	14	116,099	20.5
Të vogla	5,246	4.8	102,950	20	713,963	32.5	65,700	27.5	130,690	23
Të mesme	1,147	1	113,911	22	564,666	26	69,935	29	143,799	25.5
Nd.mëdha (250+ të punësuar)	181	0.2	103,979	20	491,685	22.5	70,041	29.5	174,890	31

3.4.2. Tregtia e jashtme e mallrave në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, 2018

2,5 % e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme eksportojnë mallra nga 2,7 % që eksportuan në vitin 2017. Vlera e eksporteve të mallrave të NVM-ve përbën 58,2 % të vlerës së eksporteve gjithsej. Sektori me përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve eksportuese është industria nxjerrëse, ku 20,9 % e ndërmarrjeve aktive të këtij sektori eksportojnë.

8,8 % e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë importuese nga 9,3 % që ishin në 2017, të cilat përbënë 78 % të vlerës së importeve të mallrave për 2018. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sektori me përqindjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve importuesve është sektori i industrisë përpunuese me 23,1 %.

Rreth 10,5 % e shitjeve neto të NVM-ve shkojnë për eksport. Ndërmarrjet e mesme kryejnë përqindjen më të lartë të eksporteve me 18,4 % të shitjeve neto të realizuara prej tyre. Mikrondërmarrjet eksportojnë vlerën më të ulët ku rreth 4,5 % të shitjeve neto janë eksportuar.

3.4.3. Struktura e punësimit sipas aktivitetit ekonomik, 2018

Përqindjen më të lartë të punësimit në mikrondërmarrje e zë sektori akomodimit dhe shërbimit ushqimor me 74,1 %. Sektori i ndërtimit ka përqindjen më të lartë të punësimit në ndërmarrjet e vogla me 28,5 % dhe në ndërmarrjet e mesme me 36,1 %.

Përqindja më e lartë e vlerës së shtuar në mikrondërmarrjet, realizohet në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (61,7 %). Sektori i tregtisë ka përqindjen më të lartë (32,6 %), të realizuar nga ndërmarrjet e vogla. Në sektorin e industrisë përpunuese, ndërmarrjet e mesme realizojnë përqindjen më të lartë të vlerës së shtuar (35,6 %) të realizuar nga ky sektor.

3.4.5. Menaxhimi i fondeve nga AIDA

3.4.5.1. Aplikimet dhe miratimet

Gjatë vitit 2019 janë financuar nga buxheti i shtetit NVM-të shqiptare, për të rritur konkurrueshmërinë e tyre, kapacitetin inovativ,

vendet e punës, gjetjen e tregjeve të reja dhe nxitjen e eksportit.

Fondet e menaxhuara nga AIDA për vitin 2019 janë:

- **Fondi i Konkurrueshmërisë** miratuar me VKM nr.24, datë 20.01.2016, me vlerë 38 milionë lekë;
- **Fondi i Ekonomisë Kreative** (Artizanati) miratuar me VKM nr.15, datë 11.01.2017 me vlerë 10 milionë lekë;
- **Fondi Start-Up** miratuar me VKM nr.593, datë 10.09.2014 me vlerë 10 milionë lekë;
- **Fondi i Inovacionit** miratuar me VKM nr.211, datë 20.04.2018 me vlerë 15 milionë lekë;


Nga fondet e AIDA-s përfituan gjithsej 94 subjekte, që ju përkasin sektorëve të ndryshëm si: agro-përpunimi, plastika, druri, ICT, fason tekstil, artizanat, turizëm.

Kjo mbështetje është dhënë nëpërmjet asistimit për certifikim, përmirësim të produktit, blerjeve të makineri pajisjeve teknologjike, prototipeve të reja të produkteve etj.


Në krahasim me vitin 2018 vihet re një rritje e numrit të aplikimeve dhe miratimeve përgjatë vitit 2019. Në mënyrë më specifike:

- Numri i aplikimeve të kompanive për të katër fondet për vitin 2019 ka një rritje prej 58 % krahasuar me një vit më parë;
- Numri i përfituesëve për të katër fondet për vitin 2019 është rritur me 66 % krahasuar me vitin 2018.

konkurrueshmërisë ka marrë 33 aplikime në krahasim me 17 kompani aplikuese në vitin 2018. Për fondin e inovacionit numri i aplikimeve është rritur me 20 kompani krahasuar me një vit më parë. Numri i aplikimeve të marra për fondin e Ekonomisë Kreative, ka qenë 22 krahasuar me 14 aplikime në vitin 2018. Rritje ka pësuar edhe numri i aplikimeve në fondin Start Up, të cilat për vitin 2019 ishin 32 krahasuar me 25 aplikime një vit më parë.



Rritja e numrit të aplikimeve por edhe përfituesëve ka ardhur si rezultat i rritjes së buxhetit për vitin 2019 për secilin prej fondeve që AIDA menaxhon.




Në vijim pasqyrohen të dhënat konkrete, sipas viteve:
Tabela e fondeve 2018/2019, sipas vlerave

Fondet e AIDAs 2019	Buxheti për vitin 2019/ në lekë	Kompani aplikuese	Kompani përfituese	Vlera e disburshuar/në mln lekë	% e realizuar
Fondi i Konkurrueshmërisë	38,000,000	33	29	32,976,822	87%
Fondi i Ekonomisë Kreative (Artizanatit)	10,000,000	22	20	9,978,321	99%
Fondi Start-up	10,000,000	32	19	9,151,378	92%
Fondi i Inovacionit	15,000,000	33	26	14,810,000	99%
Total	73,000,000	120	94	66,916,521	92%

Në vitin 2019, AIDA për fondet e

Tabela e fondeve 2018/2019, sipas sektorëve

Sektorët kryesorë të mbuluar nga fondet që AIDA menaxhon për vitin 2019 janë artizanati, sektor për të cilin AIDA menaxhon një fond të dedikuar, sektori ushqimor dhe fason & tekstile.



Në zbatim të rregulloreve respektive të fondeve, AIDA ka realizuar 23 vizita monitoruese pranë kompanive fituese të fondeve, respektivisht në qytetet Tiranë, Shkodër, Lushnjë, Berat, Elbasan, Tepelenë dhe Gjirokastrë.

gjatë vitit 2019 janë shtuar 110 profile të kompanive shqiptare me qëllim vizibilitetin e kompanive ndaj partnerëve potenciale për bërjen e biznesit. Në total në platformën B2B janë 740 profile kompanish sipas sektorëve:

3.4.5.2. Impakti i arritur nga implementimi i Fondeve

- Volumi i eksporteve mbas përfitimit të një standardi dhe nga përmirësimi i cilësisë së ambalazhimit të produktit, bazuar nga deklarimet e raporteve përfundimtare shkon nga 25-35 %;
- Rritja e kapaciteteve prodhuese të kompanive rreth 20 %;
- Rritja e numrit të punonjësve 10-25 %;
- Realizimi i produkteve të reja, diversifikim i aktivitetit të prodhimit dhe rritje e klientëve;
- Fuqizim i imazhit të kompanisë në tregjet kombëtare dhe ato ndërkombëtare;
- Implementimi i teknologjive të fundit me teknikat e monitorimit mjedisor;
- Zhvillimi i teknikave të reja monitoruese dhe rritje të profesionalitetit të stafit;
- Zbatimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e monitorimit mjedisor.

- 233 në Bujqësi
- 16 në Artizanat
- 16 në Turizëm
- 53 në TIK & BPO
- 422 në Manufakturë/Prodhim

3.4.7. Projektet

3.4.7.1. Menaxhimi dhe zbatimi i projektit "Enterprise Europe Network"

Rrjeti European i Ndërmarrjeve (Enterprise Europe Network) është rrjeti më i madh në botë, i cili mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME's/NVM) me synim inovacionin dhe rritjen e tyre në shkallë ndërkombëtare.

Ky rrjet bashkë financohet nën programin COSME (Konkurrueshmëria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme) një program i financuar nga Bashkimi European, i krijuar për të inkurajuar konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve evropiane. Rrjeti është aktiv në më shumë se 60 vende të botës. AIDA, është partneri kryesor udhëheqës i Konsorciumit Shqiptar të Enterprise Europe

3.4.6. Platforma online B2B

Në platformën online B2B të faqes së AIDA-s,

Network, i cili përbëhet në total nga 4 partnerë:

- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT)
- Insituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen (IPPM)
- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL)

Në kuadër të këtij projekti gjatë vitit 2019 janë realizuar :

- Katër (4) takime Door to Door në qytetet Peshkopi, Lushnje, Përmet dhe Gjirokastrë;
- Info day në qytetin e Vlorës, me pjesëmarrjen e 30 NVM-ve Shqiptare, të organizuar nga AIDA në bashkëpunim me Universitetin Pavarësia;
- Info day në qytetin e Shkodrës, me pjesëmarrjen e 50 NVM shqiptare, dhe organizimin e një mini panairi të artizanëve të produkteve shkodrane;
- Info day në qytetin e Korçës, me pjesëmarrjen e 25 NVM-ve shqiptare, në bashkëpunim me Inkubatorin e Biznesit në Korçë;
- Info day në qytetin e Durrësit, e organizuar nga AIDA në bashkëpunim me OJQ-në "Udhëtim i lirë";
- Prezantim gjatë veprimtarisë "Summer Academy of SMEs", në Tiranë, të organizuar nga Instituti Shqiptar i NVM-ve, me bashkëpunimin e AIDA, me pjesëmarrjen e 20 NVM-ve Shqiptare;
- Forumi i Biznesit "Shqipëri-Serbi" dhe takime B2B organizuar nga AIDA në bashkëpunim me Dhomen e Tregtisë Serbi;
- Forumi i Biznesit "Shqipëri - Kompanitë Hungareze";
- Vizita e kompanive kroate në Shqipëri. Bashkëorganizuar nga CCIT, AIDA dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Kroacisë;
- Prezantim gjatë "Samitit për Zhvillim në Inovacion", i organizuar nga INSTAT, më 21 qershor 2019 në Tiranë, me bashkëpunimin e AIDA dhe pjesëmarrjen e 25 NVM-ve shqiptare.
- AIDA në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Rinisë në Shqipëri, për iniciativën e re për "Inovacionin në start - Up".
- Janë realizuar takime periodike me partnerët e Konsorciumit, koordinimi i Konsorciumit, pjesëmarrje në trajnime, organizimi i akt-

viteteve me qëllim arritjen e rezultateve të projektit, menaxhimit të buxhetit të projektit;

- Është realizuar promovimi mediatik i projektit në televizion, emisioni "Mirëmëngjes Shqipëri", në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH);
- Shtimi i 55 profileve të kompanive shqiptare në EEN. Në total ka arritur 139 numri i kompanive shqiptare në EEN.

AIDA ka nënshkruar 3 (tre) kontrata me:

- "Life in a boat" & Kompani Mali i Zi
- "Bio Bes shpk" & Kompani Gjermane
- "Financial Core LLC" & Kompania Suedeze

3.4.7.2. Menaxhimi dhe zbatimi i projektit 'FILA'

Projekti "FILA" bashkë financohet nga BE dhe zbatohet në kuadër të programit ndërkufitar Interreg IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi, për një periudhë 2 vjeçare 01.04.2018 – 01.04.2020, por për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 kohëzgjatja e projektit është shtyrë deri në 01.01.2021. Objektivi kryesor i tij është rritja e konkurrueshmërisë së NVM-ve dhe bashkëpunimit ndërkufitar duke forcuar lidhjen ndërmjet kërkimit dhe bizneseve përmes krijimit të tre laboratorëve ndërkufitarë të fertilizimit dhe inovacionit në sektorin agro-ushqimor në Shqipëri (Korçë), Mali i Zi (Niksic-Tehnopolis) dhe Puglia (Bari - CIHEAM) bazuar në modelin FILA.

Në kuadër të këtij projekti gjatë vitit 2019 janë realizuar :

- Organizimi dhe pjesëmarrja në workshop-in e tretë të organizuar në kuadër të implementimit të projektit FILA (Interreg-IPA) me temë "Prezantim dhe diskutim mbi krijimin e Modelit të Laboratorit FILA", në qytetin e Korçës, i cili u organizua nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Zyra Rajonale e Korçës, në bashkëpunim me stafin e AIDA-s;
- Hapja e llogarisë bankare të projektit në Bankën e Nivelit II – Raiffeisen;
- Përgatitja dhe raportimi i informacioneve lidhur me situatën financiare të projektit për partnerin lider Italian;

- Përgatitja dhe raportimi i informacioneve lidhur me situatën financiare të projektit për partnerin lider Italian;
- Përgatitja e PBA-së për projektin 'FILA', në bashkëpunim me Sektorin e Financës;
- Pjesëmarrja në takimin e konsorciumit dhe takimin monitorues afatmesëm në Malin e Zi (online via skype);
- Pjesëmarrja në takimin për shpërndarjen e marrëveshjes së rrjetit midis partnerëve të projektit FILA, në Tiranë, i organizuar nga AIDA;
- Pjesëmarrja në takimin e tretë të konsorciumit mes partnerëve në qytetin e Korçës;

3.4.7.3. Histori Suksesi

Histori suksesi të Drejtorisë NVM dhe Projekte për vitin 2019 janë:

- 94 kompani përfituese të fondeve
- 51 kompani pjesëmarrëse në panairët e mbështetura nga AIDA të cilat kanë arritur të lidhin kontrata falë kësaj mbështetje (Bio Bes shpk, Rafting Vjosa)
- Kompanitë që kanë mundur të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me kompani të huaja dhe të eksportojnë falë mbështetjes së EEN ("Life in a boat", "Bio Bes shpk", "Financial Core LLC").

4 DREJTORIA MARKETING DHE KËRKIM ANALIZË

4.1. Hyrje

Drejtorja e Marketing dhe Kërkim Analizë në kuadër dhe të ristrukturimit pozicionohet në këtë ambient të ri me objektiva dhe funksione kyçe duke i përdorur të gjitha kanalet e disponueshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të komunikimit me qëllim që të përcjellë informacionin e dobishëm për të gjitha palët e interesuara në kohën e duhur.

Misioni i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë është arritja e objektivit mbi informacionet mbi tregun dhe strategjive të reja, me qëllim kërkimin në vazhdimësi për mundësi të reja investimi në Shqipëri.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka për funksion sigurimin e Komunikimit dhe Marketin-gut të institucionit për politikën, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj. Po ashtu, kjo drejtori ka për funksion kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë siguron informacione mbi tregun dhe strategjitë e reja,

kryen studime tregu dhe kërkim të dhënash me qëllim përditësimin e materialeve dhe informacioneve në funksion të drejtorive dhe investitorëve.

Drejtorja e Marketing dhe Kërkim Analizë në mbështetje të drejtorive të tjera të Agjencisë, përgjatë vitit 2019 krahas rritjes së kanaleve të komunikimit, përmirësoi përmbajtjen dhe cilësinë e komunikimit.

4.2. Rikonceptimi, ndërtimi i faqes së re web të AIDA-s

Në përmbushje të rolit dhe misionit të AIDA-s, përgjatë vitit 2019, u realizua rikonceptimi dhe ndërtimi i faqes së re web të AIDA-s, e cila përmban informacione të dobishme në ndihmë të investitorëve, kompanive vendase, si edhe ato të huaja. Website i ri përmban 7 (shtatë) rubrika kryesore me kategorizime përkatëse, të cilat ju përshtaten karakteristikave të audiencës.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë është angazhuar në menaxhimin dhe përditësimin e

përmbajtjes së faqes zyrtare të webit të Agjencisë, www.aida.gov.al, kontenti i së cilës ofrohet në gjuhën Shqipe dhe Angleze. Përditësimi i faqes zyrtare bëhet në baza të rregullta duke reflektuar praktikën më të mira ndërkombëtare dhe nëpërmjet një marketingu miks synon tërheqjen e një numri në rritje të investitorëve potencial për të vizituar faqen.

4.3. Publikime në Media Sociale

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka mundësuar funksionimin e pandërprerë, përditësimin me informacion si edhe pasqyrimin në kohë të tij, në të gjitha kanalet e komunikimit (website, facebook, instagram, twitter). Pasqyrimi i të gjitha aktiviteteve, takimeve zyrtare, konferencave, trajnimeve, etj. është pasqyruar në faqen Web dhe në Rrjetet Sociale nëpërmjet shkrimit të një lajmi në gjuhën shqipe dhe angleze si edhe shoqërimit me foto, video, infografik ilustrues etj. Të gjitha postimet në rrjetet sociale janë të shoqëruara me linke nga faja zyrtare e AIDA-s, në mënyrë që të promovohet faja zyrtare e institucionit si edhe për ta bërë më të aksesueshme nga publiku.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha informacionet mbi veprimtarinë e AIDA-s, grupeve të interesit, investitorëve, partnerëve etj. dhe ka informuar publikun e gjerë nëpërmjet mediave elektronike dhe faqes zyrtare www.aida.gov.al në kohë reale.

Një rëndësi të veçantë i është kushtuar organizimit të aktiviteteve dhe përmirësimit të imazhit duke siguruar që të dhënat, lajmet dhe materialet promovuese të Agjencisë të shpërndahen në mënyrë periodike nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të internetit.

AIDA Website

Faja zyrtare AIDA-s, së bashku me rrjetet sociale (facebook, twitter, instagram) kanë qenë shumë aktive dhe një asistencë e rëndësishme për të gjithë aktorët dhe bizneset të cilët vizitojnë faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të AIDA-s për tu njohur në kohë reale me të gjitha informacionet e pasqyruara.

AIDA Facebook

Faja e facebook ka një audiencë prej 5,523

ndjekës, numër i cili ka ardhur duke u rritur vazhdimisht që prej krijimit të faqes në vitin 2016. Faja facebook përditësohet vazhdimisht duke ofruar informacione mbi aktivitetet e ardhshme dhe të zhvilluara, mbi investimet dhe klimën e të bërit biznes, rritjen ekonomike etj.

Numri publikimeve/postimeve gjatë vitit 2019 ishte gjithsej 272 me një frekuencë publikimesh mesatarisht 22 postime në muaj si edhe me forma të ndryshme komunikimi (foto, video, infografik, live video etj).

Publikime: 125

Informacion mbi Panaire kombëtare: 14

Informacion mbi Panaire ndërkombëtare: 36

Shpërndarje/Share: 97

Publikime gjithsej janë: 272

AIDA Twitter

AIDA është aktive edhe në rrjetin social twitter duke publikuar dhe ndarë me ndjekësit informacione të rëndësishme në dobi të gjithë palëve të interesuara. Faja e twitterit ka një audiencë prej 1,948 ndjekës. Për vitin 2019, janë bërë 68 postime gjithsej.

AIDA Instagram

Përgjatë vitit 2019 u krijua një profil i ri i AIDA-s në instagram, duke krijuar një rritje të palëve të interesuara dhe njohje nga një masë me e gjerë e shërbimeve dhe rolit të institucionit. Faja e instagramit ka një audiencë prej 324 ndjekës. Janë bërë gjithsej 30 postime që nga momenti i hapjes së profilit në 30 Gusht e deri në Dhjetor 2019.

Formatet Video

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave u krijuan 6 (gjashtë) video të cilat trajtuan ndarje eksperiencash mbi mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri, shembuj investimesh të suksesshme, të cilat shoqëruan aktivitete të veprimtarisë së AIDA-s.

4.4. Transparenca e Informacionit

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka bërë monitorimin paraprak dhe konstatues në baza ditore, të përmbajtjes së çdo e-maili të ardhur në adresën zyrtare të agjencisë info@aida.gov.al. Për vitin 2019, në adresën info@aida.gov.al kanë ardhur 221 e-male për kërkesë informa-

-cioni, të cilat pasi janë shqyrtuar dhe hartuar informacioni i nevojshëm ju është dërguar kthim përgjigja brenda afateve të përcaktuara të rregullores. Për të gjitha eventet dhe aktivitetet ku AIDA ka marr pjesë ose ka organizuar janë informuar me e-maile kompanitë shqiptare sipas databazës që disponohet. Në përputhje edhe me programin e transparencës të miratuar, AIDA ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e internetit www.aida.gov.al të gjitha kategoritë e informacionit publik pa kërkesë në menunë AIDA/ Baza Ligjore AIDA - Programi i Transparencës.

4.5. Botimi dhe dizajni i materialeve promovuese

AIDA, gjatë vitit 2019 në kuadër të rritjes së vizibilitetit dhe informimit dizajnoi dhe hartoi materiale promovuese (digjitale dhe fizike) të cilat shërbejnë për informimin e investitorëve potencial dhe ekzistues si edhe promovimin e veprimtarisë së AIDAs në aktivitetet pjesëmarrëse. Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë në bashkëpunim me drejtoritë e tjera siguroi përditësimin e materialeve marketing dhe u kujdes për botimin dhe vendosjen e tyre në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë gjatë vitit 2019 pati në fokus zhvillimin dhe përgatitjen e marketingut dhe shërbimeve të nevojshme në mbështetje të drejtorive të tjera. Një rëndësi ju kushtua cilësisë përmbajtjes së informacionit të materialeve promovuese si dhe plotësimit të kërkesave të legjislacionit në fushën e botimit.

Broshura "Albania Calls - A country of opportunities"

<http://aida.gov.al/albania-calls-a-country-of-opportunities/>

Ky botim në gjuhën angleze përmban informacione të vlefshme mbi arsyet kryesore pse duhet të investosh në Shqipëri si edhe të dhëna mbi klimën e të bërit biznes në Shqipëri. Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e kësaj broshure janë edhe informacionet mbi incentivat në sektorët kryesorë të investimeve në Shqipëri si: Energjia, Turizimi, Bujqësia, Manifaktura dhe Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) të shoqëruara me pamje të pikave turistike në Shqipëri.

Broshura "Bring Your Business to Albania"

<http://aida.gov.al/bring-your-business-to-albania/>

Ky botim në gjuhën angleze përmban informacione mbi arsyet pse të investosh në Shqipëri, ligjin mbi investimet strategjike dhe investimet e huaja si edhe incentivat për sektorët me potencial zhvillimi si: Energjia, Turizmi, Agroturizmi, Manifaktura, Agrikultura dhe Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA). Ky botim i AIDA-s i drejtohet të gjithë investitorëve potencialë dhe prezanton lehtësirat e të bërit biznes në Shqipëri.

Broshura "Manuali Investimeve Strategjike"

<http://aida.gov.al/manuali-i-investimeve-strategjike/>

Në këtë botim onilne të broshurës, investitorët shqiptarë dhe të huaj të interesuar për të bërë biznes në Shqipëri, do të gjejnë të gjithë informacionin mbi legjislacionin shqiptar të investimeve strategjike, sektorët strategjikë, aplikimi për statusin e investitorit strategjikë, procedurat administrative të investimeve strategjike, organet ligj zbatuese, bashkëpunimet ndërinstitucionale për vënien në zbatim të projektit dhe marrjen e statusit të investitorit strategjik.

Broshura "Textile & workwear" in Albania

<http://aida.gov.al/textile-workwear/>

Broshura u botua në gjuhën angleze përmban informacione mbi sektorin e Tekstileve dhe Lëkurës në Shqipëri. Kjo broshurë u ofrua dhe u shpërnda për vizitorët dhe të interesuarit në panairin e veshjeve të punës A+A Dusseldorf, në formën e një kartëvizite, nga ku broshura aksesohet direkt në faqen zyrtare të AIDA-s, duke skanuar një QR kod.

Broshura "Invest in Albania"

<http://aida.gov.al/invest-in-albania/>

Ky botim në gjuhën angleze përmban informacione me të dhëna statistikore për Shqipërinë dhe ekonominë, pesë arsyet pse të investosh në Shqipëri, Investimet e Huaja Direkte, Ligjin e Investimeve të Huaja, Procedurat e për statusin e investitorit strategjik si edhe Incentivat për investimet strategjike. Pjesë e kësaj broshure është edhe informacioni mbi funksionin dhe misionin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Flyers "Fondi Konkurrueshmërisë",
"Fondi Ekonomisë Kreative",
"Fondi i Inovacionit",
"Fondi Start Up".

<http://aida.gov.al/wp-content/uploads/pdf/Fondi%20i%20Ekonomise%20Kreative.pdf>

<http://aida.gov.al/fondi-inovacionit/>

<http://aida.gov.al/fondi-start-up/>

Këto botime përmbajnë informacione mbi 4 (katër) fondet e menaxhuara nga AIDA, të cilat janë vënë në dispozicion në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, forcimin e kapaciteteve prodhuese, dhe daljen e tyre në treg. Për secilin fond jepet informacion i detajuar për fushat dhe sektorët që mbulohen si edhe kriteret dhe procedurat e aplikimit.

Flyer "Strategic Investment Step by Step"

http://aida.gov.al/wp-content/uploads/pdf/Strategic%20Investments_web.pdf

Ky botim në gjuhën angleze përmban të gjitha informacionet e nevojshme mbi procedurat e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme për përfitimin e statusit të investitorit strategjik.

City Profile Elbasan, Fier ,Shkodër

<http://aida.gov.al/city-profile-elbasan/>

<http://aida.gov.al/city-profile-fieri/>

<http://aida.gov.al/city-profile-shkodra/>

Botimet përmbajnë informacione mbi profilin e qyteteve Elbasan, Fier dhe Shkodër, indikatorët ekonomik si edhe mundësitë për investime që ofron secili nga qytetet.

Newsletter Elektronik 2019

<http://aida.gov.al/newsletter-2019/>

Newsletter-i vitit 2019, i cili u publikua dhe iu dërgua elektronikisht mbi 340 palëve të interesit, shërbeu si një kornizë pasqyrimi për të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2019. Publikimi i newsletterit ka si synim të rrisë ndërveprimin e AIDA-s me partnerët, bashkëpunëtorët dhe aktorët e interesit. Publikimi i Newsletter-i për vitin 2019, ishte një risi për AIDA-n, nëpërmjet të cilit u informuan si sipërmarrësit vendas dhe të huaj ashtu si edhe organizatat partnere mbi zhvillimet më të reja në fushën e ekonomisë, aktivitetet e agjencisë dhe mbi lajmet më të fundit në fushën e biznesit.

5 KOORDINIMI I AIDA-S

5.1. Hyrje

Në kuadër të përmbushjes së detyrave të veta ligjore, në AIDA u krijua Drejtoria e Koordinimit, si nevojë e koordinimit të aktiviteteve si brenda agjencisë ashtu edhe me institucione apo organizma të ndryshme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjithashtu kjo drejtori koordinon edhe raportimet e ndryshme të institucionit si në kuadër të performancës, ashtu edhe të raportimeve që kanë të bëjnë me angazhime në kuadër të marrëveshjeve apo nismave që Shqipëria ka në nivel rajonal apo evropian.

5.2. Outreach Campaign 1.

Në vijim të punës të nisur që në mes të vitit 2018, në muajin maj 2019 u realizua fushata e parë outreach, në Zyrë të Zvicrës. Aktiviteti u

krye në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, por edhe me ndihmën dhe mbështetjen e organizmave si IFC, Ambasadë Zvicerane, Risi Albania e SIPPO. Pjesë e outreach ishin dhe kompani shqiptare të interesuara për partneritet me kompani Zvicerane.

Aktiviteti u zhvillua në disa faza ku përfshihen: përgatitja e një prezantimi të detajuar, kontakte me kompani shqiptare të interesuara, përgatitje e fishave të projekteve, kontaktimi i kompanive Zvicerane, organizimi i eventit. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe pati edhe trajnime për stafin e AIDA, MBZHR dhe MEPJ.

5.3. Map Rea

Gjatë vitit 2019 janë ndjekur dhe është dhënë kontribut për të gjitha çështjet që lidhen me MAP REA (Plani Shumëvjeçar i Zonës Ekono-

mike Rajonale) dhe më në detaje komponenti i shtyllës së investimeve në kuadër të IRAP (Investment Reform Action Plan). Kontributi përfshin: draftimin e VKM në lidhje me IRAP (miratuar nga Këshilli i Ministrave), zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Aksioneve si dhe raportimet përkatëse.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2019 janë zhvilluar edhe disa takime si në nivel teknik në MFE, në nivel vendimmarrës në strukturat e Kryeministrit ashtu edhe me donatorët dhe aktorë të tjerë:

- 8 janar - takim në MFE për MAP REA
- 22 janar dhe 15 tetor – takim me Bankën Botërore për IRAP
- 4 mars – takim për MAP REA – KM
- 25 tetor – takim me Bankën Botërore dhe IFC për IRAP
- 21 dhe 22 nëntor – takim për IRAP – Vjenë
- 26 nëntor – takim për IRAP – MFE

5.4. Kontribute në kuadër të BE.

AIDA është kontribuuese gjithashtu në kuadër të përafrimit të legjislacionit me BE, kryesisht në

Kapitullin 20 “Për politikat industriale”. Në këtë kuadër është marrë pjesë në disa takime si dhe janë kryer një sërë raportimesh.

- 23 janar – takim për Kap 20 - MFE
- 29 janar – Takimi i ECOFIN (komisioni ekonomi –financë) Bruksel
- 27 shkurt – takim i GNP (Grupit Ndërinstitucional të Punës) të Kapitullit 20
- 10 prill – raportim në kuadër të takimit të 10 të Nënkomitetit BE - Shqipëri
- 12 korrik – kontribut për planifikimin e akteve të PKIE (Plani Kombëtar i Integritimit Evropian për periudhën 2020-2022)
- 23 korrik – Alokimi i Përgjegjësisë Nominative për Kapitullin 20
- 13 gusht – raportim në MFE në kuadër të Nënkomitetit të tregtisë me BE
- 22 gusht – takim në MEPJ për Nënkomitetin BE - Shqipëri
- 23 shtator – raportim për KSA (Këshilli i Stabilizimit Asociimit) në lidhje me politikat industriale
- 30 shtator – takim në MEPJ në lidhje me Nënkomitetin BE - Shqipëri
- 3 tetor – Takim i Nënkomitetit BE – Shqipëri në Bruksel.

6 AIDA NË AKTIVITETE DHE PANAIRES

6.1. Pjesëmarrja dhe Organizimi i Aktiviteteve

6.1.1. Aktivitete lokale me qëllim mbështetje dhe informim të biznesit

Përgjatë këtij viti AIDA ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme aktivitete, seminare informuese dhe takime door to door me bizneset, me qëllim informimin e tyre mbi shërbimet kryesore që AIDA ofron si dhe mënyrat e mundshme të përfitimit të fondeve.

Seminaret informuese (info day) janë organizuar në qytete të ndryshme të vendit si: Korçë, Vlorë, Tiranë, Shkodër dhe Durrës. Gjithashtu janë realizuar 9 (nëntë) takime për promovim në qytetet: Berat, Lushnjë, Divjakë, Elbasan, Tiranë dhe Durrës. Këto takime janë realizuar në bashkëpunim me Dhomat e Tregtisë dhe Shoqatat e Biznesit.

6.1.2. Panaireset, subjektet pjesëmarrëse dhe roli i AIDA-s në mbështetjen ndaj këtyre bizneseve

Pjesëmarrja e bizneseve shqiptare në panaire jashtë vendit është një mbështetje e veçantë në përpjekjet e qeverisë shqiptare, nëpërmjet AIDA-s për të nxitur biznesin vendas dhe veçanërisht atë eksportues.

AIDA nëpërmjet mbështetjes apo organizimit të pjesëmarrjes në panaire synon promovimin e biznesit shqiptar në sektor specifik, mundësimin e takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet dhe mbështetjen e kompanive shqiptare me logjistikë për takimet e planifikuara, ritjen e eksportit në këtë sektor, tërheqjen e investitorëve të huaj për investime në vend dhe promovimin e Shqipërisë.

6.1.3. Lista e panairove pjesëmarrëse, 2019

Agjencia, në funksion të veprimtarisë së saj, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e bashkëpunuar me organet shtetërore. Agjencia, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siguron të dhëna të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve. AIDA ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në përfitimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare, si nëpërmjet fondeve të menaxhuara nga AIDA, por edhe nëpërmjet informimit dhe sigurimit të kontakteve për projekte partnere dhe jo vetëm. Nëpërmjet pjesëmarrjes në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare, AIDA promovon produktet dhe shërbimet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve "Made in Albania".

Panaire Kombëtare:

- Panairi "Agro Tech", Expo City, Tiranë, datë 14-15 mars 2019;
Pjesëmarrëse nëntë (9) kompani;
Pesëmbëdhjetë (15) takime të realizuara me kompanitë austriake.
- Panairi i Tekstilit dhe Lëkurës, Tiranë, datë 1-2 nëntor 2019;
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët dhe në takimet B2B;
Pikë e rëndësishme informacioni për sektorin dhe ndihmë për bizneset vendase dhe ato të huaja.

Panaire Ndërkombëtare

- Panairi "Bio Fach", Nurenberg, datë 13-15 shkurt 2019;
Pjesëmarrëse gjashtë (6) kompani shqiptare;
Arritje të këtij panairi përmendim realizimin e tre (3) kontratave me vlerë 135.000 franga.

- Panairi Ndërkombëtar i Turizmit, Berlin "I.T.B Berlin Fair", datë 6-10 mars 2019;
- Panairi i Turizmit Ndërkombëtar, Tiranë, datë 5-6 prill 2019;
Pjesëmarrëse shtatë (7) kompani;
Dhjetë (10) takime të realizuara me kompani holandeze dhe belge;
Arritje të këtij panairi përmendin realizimin e dy (2) kontratave.
- Study Tour, Panairi i Tekstileve, Mynih, Gjermani, datë 3-5 shtator 2019.
Prezantim mbi sektorin e veshjeve dhe tekstileve në Shqipëri në kuadër të bashkëpunimit me SIPPO Albania;
Takime me disa kompani si: rrjetin gjerman të modës Design VDMD, me organizatorët e panairit Pure London, Agjencinë e Investimeve të Vietnamit, Dhomat e Tregtisë së rajonit të Ballkanit.
- Panairi A+A Dusseldorf, Gjermani, datë 5 – 8 nëntor 2019;
Pjesëmarrëse pesë (5) kompani shqiptare;
Tetëdhjetë (80) takime bilaterale të realizuara.
- Panairi Ndërkombëtar i Tiranës, Tiranë, datë 23 - 26 nëntor 2019;
Pjesëmarrëse pesëmbëdhjetë (15) kompani shqiptare;
Takime B2B ndërmjet bizneseve shqiptare dhe kompanive të huaja të ardhura nga Serbia, Hungaria, Italia, Turqia etj.
- Panairi Ndërkombëtar "Artigiano in Fiera", Itali, 30 nëntor – 8 dhjetor 2019;
Pjesëmarrëse nëntë (9) kompani shqiptare.
Tetëdhjetë (80) takime të realizuara me persona të interesuar për të blerë produktet shqiptare.

- AIDA gjithashtu ka lehtësuar pjesëmarrjen e kompanive shqiptare në aktivitetin B2B me temë "Free from Food Expo", organizuar në Barcelonë, më 28-29 Maj 2019.

Tabela përmbledhëse e Panaireve 2019

Panairët	Pjesëmarrësit	Kontaktet	Kontrata/oferta
8	52	545	30 oferta
			5 kontrata

Arritjet për sa i përket pjesëmarrjes në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare:

- Interesi i lartë i kompanive për pjesëmarrje në panaire dhe ofrimi i trajnimit të tyre nga AIDA;
- Prezantimi për herë të parë i potencialeve të sektorit të tekstileve në Shqipëri, së bashku me vendet e rajonit në Study Tour, Panairi i Tekstileve, Gjermani dhe promovimi i sektorit të Artizanatit dhe i produkteve artizanale "Made in Albania" në panairin "Artigiano in Fiera", Itali.
- Rritja e numrit të panairove ku AIDA mori pjesë në menyrë të organizuar së bashku me SIPPO- Zvicër.
- Rritja e numrit të kontakteve dhe të takimeve B2B me kompani të huaja.
- Rritja e numrit të 137 ofertave të interesit për të lidhur kontrata.

6.2. Bashkëpunime dhe partneritete të realizuara në kuadër të SME-ve dhe Projekteve

- Bashkëpunimi i AIDA-s me partnerë dhe aktorë të ekosistemit të mbështetjes së biznesit në Shqipëri dhe jashtë, me qëllim ndërkombëtarizimin e kompanive shqiptare;
- Bashkëpunimi me GIZ, projekti IDEA dhe klasteri i parë i drurit në Shqipëri;
- Bashkëpunimi me SIPPO, përgatitja e sistemit CRM, pjesëmarrja në panairët si "Bio-Fach" dhe "A+A Dusseldorf Workwear";
- AIDA dhe SIPPO organizuan workshopin me temë "Tregu ndërkombëtar i tekstileve", mbajtur në ambjentet e Dhomës Britanike të Tregtisë dhe Industrisë, në datat 14 – 15 Maj 2019;
- AIDA, pjesë e workshopit "The role of the financial sector as catalyst for economic growth", organizuar nga Banka Botërore;
- AIDA dhe SIPPO realizuan study tour-in në Mynih, Gjermani me temë "Munich Apparel Source" në datat 3-5 shtator 2019;

- Bashkëpunimi me RISI Albania, mbi pjesëmarrjen në Panairin Biofach 2020.

6.3. Konferenca dhe Forume

Gjatë vitit 2019, AIDA ka zhvilluar një sërë konferencash dhe forumesh, të tilla si:

- 24 - 25 tetor, u zhvillua në Tiranë "INN Fest 2019", takimi më i madh i inovacionit në Ballkan, i cili u kthye në një pikëtakimi për shumë kompani nga e gjithë bota, që sollën risitë më të fundit teknologjike. INN Fest 2019 është krijuar për të qenë konferenca më e rëndësishme rajonale për inovacionin dhe teknologjinë, e cila synon mbështetjen, investimin dhe zhvillimin e ideve të reja inovative mbi industrinë dhe ndërmarrjet;
- 19 korrik 2019, pjesëmarrja në Forumin e Biznesit "Shqipëri – Kroaci" dhe takime B2B;
- 6 qershor 2019, Forumi i 2-të i Konsulencës Shqiptare me temë "Investimi për eksporte dhe partneritete ndërkombëtare në shërbimet e konsulencës";
- 20 nëntor 2019, pjesëmarrje në Konferencën "Formim profesional praktik dhe modern për të plotësuar nevojat e biznesit me fuqi punëtore të kualifikuar", organizuar nga Dhomë Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me Dhomën e Zejeve Koblenz;
- 22 nëntor, Panairi TT në Varshavë, Poloni. Pjesëmarrje në konferencën me temë "Shqipëria, destinacioni i ardhshëm për Turizëm, Tregti dhe Investim" dhe prezantim mbi investimet në sektorin e turizmit;
- 23-26 nëntor 2019, Tirana International Fair. Prezantim mbi investimet strategjike dhe shërbimet në ndihmë të SME-ve shqiptare.

6.4. Aktivitete në kuadër të shërbimeve Aftercare

Në kuadër të përkujdesjes ndaj investitorit, AIDA ka zhvilluar disa takime, të cilat kanë

ndikuar në përmirësimin dhe vazhdimësinë e punës të kompanive të asistuar.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2019 janë zhvilluar nga sektori Aftercare i AIDA 41 vizita në bashkëpunim me bashkitë e qyteteve: Tiranë, Elbasan, Durrës, Berat, Lezhë, Vlorë, Shkodër dhe Fier.

- Mars 2019 – vizitë në kuadër të Programit "Investment promotion & Aftercare" Shkodër. Kompanitë e vizituara: "FamikoShoes", "Moda Teli", "B&G Service Group", "UnikalIndustries", "Dafinor".
- Prill 2019 – vizitë bizneseve në qytetin e Elbasanit. Kompanitë e vizituara: "Delmon Group" dhe "IT&AL", "Bio Funghi", "Dieta sh.p.k" dhe "Victus FED".
- Prill 2019 – vizitë bizneseve në qytetin e Vlorës. Kompanitë e vizituara: "Helios", "Simak Shoes", dhe "TomaificioMaro" "Alb Sale", "MetalPro 2015".
- Prill 2019 – vizitë bizneseve në qarkun Durrës. Kompanitë e vizituara: "Rework sh.p.k", "Giobert" dhe "Climb Cat".
- Qershor 2019 – vizitë bizneseve në qytetin e Lezhës. Kompanitë e vizituara: "Amarilto" dhe kantina e verës "Kallmet".
- Qershor 2019 – vizitë në funksion të rritjes së koordinimit dhe bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore, Berat. Kompanitë e vizituara: "Center Shqiptare sh.p.k", "Caterina Firenze", "Intex dhe Vakëfi".

Në kuadër të funksioneve aftercare, janë zhvilluar dy takime:

- 14 janar – takim në zyrat e BPO Fussion në Tiranë;
- 16 korrik – takim në ambientet e kompanisë Marlotex në Berat.

6.5. Organizim dhe pjesëmarrje në evente dhe forume

Gjatë vitit 2019 është marrë pjesë në disa forume e evente si në rol bashkë organizatorësh apo pjesëmarrësish:

- 22 shkurt – Prezantim i shërbimeve të AIDA në aktivitetin e organizuar nga Shoqata AITA.
- 4 korrik – Pjesëmarrje me stendë në Samitin e Poznanit, ku përveç takimeve me biznese

pati edhe takime me koleget e agjencisë homologe të Polonisë ku u diskutua në lidhje me bashkëpunime sidomos në fushën e elektromobilitetit.

- 12 korrik – Përrurimi i fabrikës së Yura CO Albania në Fier.
- 18 korrik - Forum biznesi me bizneset Kroate. Aktivitet i Dhomave të Tregtisë të dy vendeve, ku u prezantuan oportunitetet për investime dhe shërbimet e AIDA.

Në tremujorin e fundit të vitit 2019, kryesisht në bashkëpunim me MEPJ ishin parashikuar një numër aktivitete në kuadër të diplomacisë ekonomike, aktivitete të cilat nuk mundën të zhvilloheshin për shkak të tërmeteve që goditën Shqipërinë në nëntor 2019. Aktivitetet janë shtyrë për t'u zhvilluar gjatë vitit 2020.

6.6. Takime dhe aktivitete në kuadër të tërheqjes së investitorëve në Shqipëri

- 17 janar – takim me GIZ dhe investitorin gjerman CTA;
- 18 janar – takim me investitor turk në lidhje me hapjen e një spitali në Shqipëri;
- 25 janar – takim me investitorët e FEZ (Free Economic Zone) dhe Zv/Ministren e MFE;
- 25 korrik – takim me një grup biznesesh Sll-ovake;
- 30 korrik dhe 8 gusht – takim me Risi Albania në lidhje me investimet në sektorin e BPO;
- 20, 21 dhe 22 gusht – takime me Nordex dhe shoqërim në terren i investitorit;
- 15 nëntor – takim me përfaqësues të ambasadës Bullgare në Tiranë;
- 6 gusht – takim me Sekretariatit e Këshillit të Investimeve - interviste në lidhje me klimën e investimeve në Shqipëri;
- 29 gusht – pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit të Investimeve me tematikë problemet e pronësisë në Shqipëri – MFE.

7 AIDA NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RITJES SË IMAZHIT NDËRINSTITUCIONAL

7.1. Programi i transparencës

Si një institucion publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, dhe që drejtohet nga bordi drejtues, AIDA funksionon në përputhje me standardin e transparencës duke siguruar gjatë veprimtarisë së saj zbatimin rigoroz të detyrimeve që rrjedhin prej Ligjeve 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Përgjatë vitit 2019, në zbatim të nenit 5 të Ligjit nr. 119/2014, AIDA ka kryer rishikimin e Programit të Transparencës të miratuar, duke e përditësuar me ndryshimet e nevojshme.

Në procedurën e rishikimit janë vlerësuar edhe ndryshimet në strukturën dhe organikën e institucionit, të cilat diktuan një ndarje të re të detyrave dhe përgjegjësi të secilës njësi organizative për konceptimin dhe zbatimin e programit të transparencës, duke vlerësuar praktikën e mira ndërkombëtare të miratuara në Autoritete Publike të njëjta, si dhe duke synuar në tërësi përmirësimin e tij.

Në përgatitjen e rishikimit të programit të transparencës është mbajtur parasysh interesi më i lartë i publikut, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesat individuale për informacion dhe sidomos:

- Garantimin e njohjes maksimale me informacion për të gjitha fushat e veprimtarisë së institucionit;
- Vënien në dispozicion, pa kërkesë, të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- Modelet e miratuara për kategoritë e institucioneve publike nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Gjatë vitit raportues, në veprimtarinë e AIDA-s ka qenë thelbësore rritja e transparencës dhe llogaridhënies, në veçanti duke siguruar funksionimin efikas dhe transparent të sistemit të prokurimit publik, menaxhimit të financave publike, legjislacionit, mekanizmave monitorues, strukturës organizative të AIDA-s, deklarimet e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë,

Në kuadër të zbatimit të ligjit 119/2014 dhe qasjes pro aktive për informacione që promovojnë interesin publik të përcaktuar në drejtim të dhënies së informacionit, AIDA ka vendosur në shërbim të publikut dhe palëve të tjera të interesuara, informacione dhe të dhëna konkrete në lidhje me investimet e huaja direkte dhe investime strategjike, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe sektorët e nënsektorët strategjikë, sikurse edhe masat mbështetëse dhe procedurat e aplikimit.

Për të siguruar një transparencë sa më efektive, AIDA ka vënë në dispozicion të publikut manualin udhëzues mbi legjislacionin e investimeve strategjike, por edhe rregulloren e Komitetit të Investimeve Strategjike dhe Vendimet e tij.

Duke qenë se për qëllim të përmirësimit të klimës së investimeve dhe mjedisit të biznesit, qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt një qasje të re politike në zbatimin e paketave ligjore specifike preferenciale, duke krijuar Zona të reja Teknike dhe Ekonomike të Zhvillimit (TEDA), të përcaktuara posaçërisht për zhvillimin e parqeve industriale që do të përfitojnë nga legjislacioni i veçantë dhe stimujt për investime, AIDA gjithashtu i ka mundësuar publikut një akses të veçantë në informacionet dhe të dhënat kryesore lidhur me këto hapa. Në mënyrë specifike, publiku ka mundësinë të marrë një informacion të shpejtë dhe pa kosto të lejeve të lidhura me veprimtaritë e investimeve strategjike në këto zona, sipas legjislacionit të

investimeve strategjike.

Duke qenë se qeveria shqiptare, në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, forcimin e kapaciteteve prodhuese dhe daljen e tyre në treg, ka vënë në dispozicion disa skema financiare të menaxhuara nga AIDA, çdo palë e interesuar mund të gjejë fare lehtë bazën ligjore, si dhe të gjithë informacionet dhe të dhënat e nevojshme mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të fondeve përkatëse.

Gjithashtu, sipas orientimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AIDA, në përmbushje të detyrimeve ligjore, me qëllim përcaktimin e procedurave organizative e teknike, masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale, ka miratuar me urdhrin nr. 176 prot. datë 23.12.2019, të Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s, Rregulloren "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)".

Miratimi kësaj rregulloreje është bërë me qëllim mbrojtjen e çdo informacioni në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Së fundmi, AIDA, në faqen zyrtare të internetit ka publikuar edhe dokumentin "Politika e privatësisë", me anë të të cilit njofton të gjithë përdoruesit e faqes mbi ruajtjen e privatësisë së tyre, duke u treguar se çfarë duhet të presin kur AIDA mbledh të dhënat e tyre personale.

Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dhe formularët elektronikë për kërkesa/ankesa, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut.

Në çdo rast, për çdo pyetje dhe informacion të mëtejshëm, në kuadër të programit të transparencës publikut i janë vënë në dispozicion edhe të dhënat e kontaktit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave

Personale pranë AIDA-s.

7.2. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Duke konsideruar menaxhimin e burimeve njerëzore si një prej elementëve thelbësor për krijimin e një administrate profesionale, të qëndrueshme, efektive dhe të përgjegjshme, AIDA ka synuar përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative me standardet dhe praktikrat me të mira në vend. Ndryshimet në strukturën dhe organikën e AIDA-s, të shoqëruara me ndryshimin e legjislacionit zbatues për rregullimin e marrëdhënieve të punës së punonjësve të institucionit, diktuan një qasje të re të AIDA-s në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të veta ligjore.

Për këtë arsye, u miratuan edhe kërkesat specifike të pozicioneve të punës së AIDA-s, me qëllim ndarjen sa më efektive të detyrave dhe funksioneve të pozicioneve të reja të punës, duke synuar pasjen dhe rekrutimin e punonjësve, të cilët të mund të përballojnë sfidat dhe proceset që diktohen nga ndjekja e aktiviteteve kryesore të secilit pozicion punë.

AIDA, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse ka organizuar dhe drejtuar punën për zbatimin me përpikëri të legjislacionit të punës, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, rritjen e mobilitetit, zhvillimit të karrierës, si dhe përmirësimit të sistemit të trajnimit të stafit.

Gjatë vitit raportues, u miratua me Urdhrin Nr.172, datë 18.12.2019 të Drejtorit Ekzekutiv Kodi i Brendshëm Etik. AIDA nuk ka pasur një Kod të Brendshëm Etik të mëparshëm. Hartimi dhe miratimi i tij ishte një detyrim ligjor, në bazë të të cilit punonjësit e AIDA-s duhet të ushtrjnë detyrat dhe funksionet e tyre në mënyrë profesionale dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin specifik për krijimin e agjencisë, legjislacionin mbi kodin e punës, statutin dhe rregulloren e brendshme të institucionit, si dhe Kodin e Brendshëm të Etikës. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit të brendshëm dhe marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme për punonjësit

e institucionit. Kjo rregullore përcakton rregulla mbi koordinimin e funksioneve, administrimin e dokumentacionit, pajisjeve, orarit zyrtar, rregullat e etikës dhe procedura të tjera të menaxhimit, gjithashtu përgjegjësitë dhe detyrat e çdo drejtorie dhe sektori si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit.

Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës përkatëse. Në rregullore ekzistojnë gjithashtu përgjegjësitë dhe detyrat e çdo drejtorie dhe sektori si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit. Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës përkatëse.

Në këtë mënyrë, duke përcaktuar standardet etike, përmes ofrimit të udhëzimeve e kërkesave të nevojshme për t'u zbatuar nga punonjësit e AIDA-s, Kodi i Brendshëm Etik përfaqëson një deklaratë gjithëpërfshirëse të vlerave, sjelljeve dhe parimeve, të cilat duhet të udhëheqin të gjithë veprimtarinë e punonjësve të AIDA-s.

Qëllimi i këtij Kodi është që të pajisë të gjithë punonjësit e AIDA-s me një bashkësi parimesh, vlerash dhe standardesh, në të cilat të bazohet sjellja etike e tyre në funksion të përmbushjes së pritshmërisë së palëve të interesuara, ku kryerja e detyrave dhe përmbushja e detyrimeve duhet të mbizotërojë mbi interesat e çdo punonjësi të AIDA-s.

7.2.1. Punësimet


Drejtorja ka ndjekur me rigorizitet zbatimin e Vendimit nr. 1 datë 25.03.2019 të Bordit Drejtues të AIDA-s, me të cilin është vendosur që "Marrëdhëniet e punës për punonjësit e AIDA-s të rregullohen me Kod Pune", duke zbatuar të gjitha përcaktimet ligjore për daljen e punonjësve nga shërbimi civil dhe rregullimin e marrëdhënies së tyre të punës sipas dispozitave të kodit të punës.

Në përfundim të vitit raportues, rezultojnë se në AIDA janë:

- Lidhur 20 kontrata të reja pune;
- Konfirmuar 17 kontrata ekzistuese;
- Miratuar 6 largime me kërkesën e tyre;

- Vendosur 3 largime nga detyra për shkak të marrjes së masave disiplinore.

Pasqyra e rekrutimeve



Për sa i përket procedurave lidhur me marrëdhëniet e punës, rezultojnë se gjatë vitit 2019 është hapur vetëm 1 proces gjyqësor, ku një prej punonjësve të larguar nga shërbimi civil ka kundërshtuar procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Ky proces ka përfunduar në shkallë të parë në favor të AIDA-s (rrëzim i kërkesë padisë së paditësit).

7.2.2. Zhvillimi i burimeve njerëzore

Gjithashtu në kuadër të zhvillimit dhe ngritjes së aftësive profesionale të kapaciteteve njerëzore e në vijim të strategjisë së trajnimeve për vitin 2019, pjesa më e madhe e stafit ka ndjekur trajnime nga ASPA me tema të përgjithshme për ngritjen e aftësive prezantuese, të punuarit në grup, të cilat janë organizuar edhe në ambientet e AIDA-s, me ekspertë të huaj.

7.2.3. Studentët ekselentë

Gjatë vitit 2019, AIDA është bërë pjesë e të dy raundeve të organizuara nga Drejtoria e Administratës Publike (DAP) mbi rekrutimin e studentëve të ekselencës. Në raundin e parë dhe të dytë janë punësuar respektivisht 2 dhe 8 studentë ekselence.

7.3. Treguesit financiarë

7.3.1. Menaxhimi i burimeve financiare

7.3.1.1. Fondet buxhetore

AIDA për vitin 2019 ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore si më tej vijon:

Raporti i shpenzimeve të programit sipas shpenzimeve

								në lekë
Emri i Grupit	Ministria e Financave dhe Ekonomisë						Kod i Grupit	10
Programi	Meshtetja për zhvillim ekonomik						Kodi i Programit	04130
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2018	PBA Plan Viti 2019	Buxheti Vjetor Plan Fillimstar Viti 2019	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/progressiv	Fakti i Periudhës/progressiv	Diferenca
600	Paga	21,230,225.0	25,860,000.0	25,860,000.0	25,860,000.0	25,860,000.0	26,433,158.0	-2,426,842.0
601	Spjime Shogjore	3,453,544.0	4,840,000.0	4,840,000.0	4,840,000.0	4,840,000.0	4,284,599.0	-2,555,401.0
602	Makra dhe Shërbime të Tjera	7,377,413.0	19,000,000.0	19,000,000.0	19,000,000.0	19,000,000.0	15,553,664.0	-3,446,336.0
603	Subvencione							0.0
604	Transferita Korente të Brendshme							0.0
605	Transferita Korente të Huaja							0.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			100,000.0	100,000.0	100,000.0	90,000.0	-10,000.0
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	32,061,182.0	49,700,000.0	49,800,000.0	54,800,000.0	54,800,000.0	46,361,421.0	-8,438,579.0
230	Kapitale të Patrupzuar		15,000,000.0	15,000,000.0	15,000,000.0	15,000,000.0	14,806,572.0	-193,428.0
231	Kapitale të Trupzuar	33,277,904.0	75,300,000.0	75,300,000.0	63,673,200.0	63,673,200.0	55,328,683.0	-8,344,817.0
232	Transferita Kapitale							0.0
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	33,277,904.0	90,300,000.0	90,300,000.0	78,673,200.0	78,673,200.0	70,135,255.0	-8,537,945.0
230	Kapitale të Patrupzuar							0.0
231	Kapitale të Trupzuar							0.0
232	Transferita Kapitale							0.0
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	Shpenzime Kapitale	33,277,904.0	90,300,000.0	90,300,000.0	78,673,200.0	78,673,200.0	70,135,255.0	-8,537,945.0
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti								0.0
Totali (korrente +kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		65,339,086.0	140,000,000.0	140,100,000.0	133,473,200.0	133,473,200.0	116,496,676.0	-16,976,524.0

Gjatë zhvillimit të aktivitetit të institucionit nëpërmjet strukturave drejtuese, deri në vendimarrje, udhëzimeve përkatëse për zbatimin e buxhetit 2019, janë miratuar procedura, veprime të cilat synojnë reduktimin e risqeve me synimin arritjen e objektivave të institucionit si dhe për të nxitur zbatimin e vendimeve të titullarit. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, ato janë përfshirë te proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen.

Institucioni ynë, konstaton se ka përmbushur kërkesat ligjore minimale dhe ka vënë në zbatim kontrole të përshtatshme në fushat: ekzistencën e rregullave/urdhreve të brendshme për përshkrimin e proceseve kryesore operacionale dhe financiare, sistemin e firmës së dyfishtë; ruajtjen e aktiveve dhe ndarjen e detyrave; dokumentimin e të gjitha operacioneve, veprimeve dhe transaksioneve financiare si dhe procedura të tjera të miratuara në aktivitetin kryesor deri në vendimarrje.

Janë ndjekur procedurat e prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006

“Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, udhëzimit nr.3 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 5 datë 11.1.2018; si dhe procedurat me tenderim mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga strukturat e ngritura me urdhër për zbatimin e procedurave standarde të miratuara.

Në AIDA, kontrolli i brendshëm është një ndër preokupimet kryesore të menaxhimit të lartë dhe trajtohet me prioritet nga nëpunësit autorizues dhe nëpunësi zbatues duke synuar një mbështetje të gjerë të gjithë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Mbështetur në detyrimet e përcaktuara në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si edhe udhëzimet e dhëna nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, titullari i njësies është përgjegjës, për krijimin dhe monitorimin e kontrollit të brendshëm brenda strukturës që drejton.

7.3.1.2. Planifikim.

Gjatë vitit 2019 janë kryer veprime dhe hapa drejt një menaxhimi efikas financiar ashtu siç është detajimi i shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale për vitin 2019 mbi bazën e fondeve të alokuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në artikujt për paga, sigurime shoqërore, shpenzime për mallra e shërbime, transferime në buxhete familjare si dhe investime, sipas projekteve të miratuara në nivel mujor e vjetor. Rishikimi i planeve të detajuara në muaj për shpenzimet operative dhe investime për vitin 2019 si dhe rishpërndarja e tyre në muajt pasardhës në zbatim të udhëzimit të përhershëm "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe duke respektuar udhëzimet e vendosura nga Ministria e Financave. Sektori i financës ka realizuar përgatitjen dhe rakordimin e llogarive vjetore si dhe plotësimin e pasqyrës financiare me anekset përkatëse mbi gjendjen e aseteve fikse e qarkulluese dhe gjendjen financiare në fund të vitit 2018, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 28.04.2004 "Për bilancin kontabël dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006; si dhe udhëzimeve në fuqi brenda afateve kohore. Është planifikuar dhe përgatitur kërkesa pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për nevojat buxhetore për fonde, në programin "Mbështetje për zhvillim ekonomik", në zbatim të Udhëzimit "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022", si dhe të udhëzimit "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm", me anekset e tyre përkatëse, gjatë të dy fazave, Prill dhe Gusht 2019. Gjithashtu janë planifikuar dhe realizuar transferimet e fondeve në zërat e kërkuara për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë për transferime në buxhetet familjare; Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka mbështetur financiarisht stafin e AIDA-s duke organizuar aktivitete social- kulturore me qëllim rritjen e frymës së bashkëpunimit të tij. Ndryshimi nga një vit më parë është dukur edhe hartimin e raportit vjetor për vlerësimin e sistemit ekzistues, menaxhimit financiar si dhe cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm, plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit MFK në zbatim dhe përputhje të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

7.3.1.3. Mjedisi i kontrollit

Në AIDA, mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit dhe përfshin vendosjen e objektivave që sigurojnë përmbushjen e misionit të çdo njësie, etikën personale dhe profesionale, strukturën organizative, filozofinë dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Vendimmarrja e institucionit është e përcaktuar në ligjin Nr.10303 datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", dhe AIDA funksionon në zbatim të këtij ligji i cili rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e saj. Shumica e vendimeve të agjencisë merren nga Drejtori Ekzekutiv, por ndryshimet rrënjësore si janë organika e institucionit dhe statuti i tij, kanë nevojë për një vendimarrje të cilësuar dhe merren nga Bordi Drejtues. Vendimet më të rëndësishme marrë nga bordi për vitin 2019 janë:

- Vendimi i Bordit Drejtues Nr.1 datë 25.03.2019 mbi "Për një ndryshim në Vendimin Nr.2", datë 04.01.2011 "Për miratimin e statutit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)" ku u miratuan ndryshimet mbi marrëdhëniet e punës për punonjësit e agjencisë dhe u vendosën rregullat mbi përzgjedhjen e kandidatëve për punësim.
- Vendimi i Bordit Nr. 3, datë 7.06.2019 "Miratimin e Niveleve të Pagave dhe të Strukturës e Organikës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)" u vendos kategorizimi i ri i pagave si dhe grupet e diplomave të nëpunësve të AIDA-s; elementet e pagave dhe shtesa mujore në varësi të kategorive, gjendet bashkëlidhur këtij vendimi si relacion shpjegues.

7.3.1.4. Menaxhimi i Riskut

Për vitin 2019, hartimi i Regjistrit të riskut dhe i strategjisë së minimizimit të tij është një proces me të cilin jemi informuar dhe janë marrë udhëzimet e nevojshme për realizimin e detyrimeve sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore përkatëse,

AIDA me anë të vendimit të titullarit nr.5 dt 15.01.2020 "Për hartimin e strategjisë dhe menaxhimit të riskut për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve"; ka realizuar regjistrin e riskut duke marrë për referencë, përveç ligjit për menaxhimin financiar dhe manualit të tij, shembullin e regjistrit të riskut të përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si edhe objektivat e identifikuara në PBA.

7.3.1.5. Informacioni dhe Komunikimi

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet sipas rregullores së brendshme të agjencisë duke respektuar nivelin e hierarkisë, në mënyrë shkresore dhe elektronike. Kujdes të veçantë i kushtohet komunikimit të informacionit në formën dhe kohën e duhur në mënyrë që të përmbushen sa më mirë përgjegjësitë e punonjësve dhe drejtuesve. Të gjithë punonjësit e AIDA janë trajnuar për përdorim të sigurt dhe të drejtë të komunikimeve elektronike zyrtare bazuar në rregulloret e hartuar nga AKSHI mbi përdorimin e postës elektronike në administratën publike dhe përdorimin e shërbimit të internetit në administratën publike. AIDA ka zbatuar të gjitha standardet TIK të hartuara nga AKSHI në lidhje me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të internetit.

Në rastet e shkeljes së afateve të caktuara janë marrë edhe njoftime për tërheqje vëmendje apo masë disiplinore nga eprorët direkt. Informacioni dhe komunikimi lidhen gjithashtu edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në AIDA.

7.3.1.6. Monitorimi

AIDA ka marrë masat për realizimin e monitorimit duke hartuar raportin e monitorimit dhe dërguar në MFE nëpërmjet shkresës nr.70 prot., datë 14.02.2020 "Dërgohet Raporti i Monitorimit për

vitin 2019".

Monitorimi kryhet nëpërmjet matjes së performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, analizave të zbatimit të buxhetit çdo 3-mujor, dhe në progresiv 6- mujor, 9-mujor. Monitorime të veçanta janë realizuar sa herë ka lindur nevoja nga titullari dhe drejtuesit e drejtorive të njësisë. Për monitorimin e proceseve dhe aktiveve përdoren një sërë procedurash nga titullari, nëpunësi zbatues si dhe drejtuesit e tjerë. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për e monitorimin strategjive dhe objektivave, si dhe standardeve të përcaktuara në Programin Buxhetor Afatmesëm.

7.3.2. Zbatimi i Buxhetit

Gjatë zhvillimit të aktivitetit të institucionit nëpërmjet strukturave drejtuese, deri në vendimarrje, udhëzimeve përkatëse për zbatimin e buxhetit 2019, janë miratuar procedura, veprime të cilat synojnë reduktimin e risqeve me synimin për të arritur objektivat e institucionit si dhe për të nxitur zbatimin e vendimeve të titullarit. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, ato janë ingranuar tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen.

Institucioni ynë, konstaton se ka përmbushur kërkesat ligjore minimale dhe ka vënë në zbatim kontrole të përshtatshme në fushat: ekzistencën e rregullave/urdhreve të brendshme për përshkrimin e proceseve kryesore operacionale dhe financiare, sistemin e firmës së dyfishtë; ruajtjen e aktivëve dhe ndarjen e detyrave; dokumentimin e të gjitha operacioneve, veprimeve dhe transaksioneve financiare si dhe procedura të tjera të miratuara në aktivitetin kryesor deri në vendimarrje.

Janë ndjekur procedurat e prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, udhëzimit nr.2 "Për procedurën e blerjeve të vogla" si dhe procedurat me tenderim mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara nga Ministria e Financave, nga strukturat e ngritura me urdhër për zbatimin e procedurave standarde të miratuara.

7.3.3. Gjetjet nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Gjatë auditimit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në vitin 2019 për periudhën janar 2018-korrik 2019 në AIDA, janë dhënë një sërë rekomandimesh të cilat synojnë përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Në përfundim të auditimit të kryer, janë dhënë rekomandime në varësi të gjetjeve sipas subjekteve të audituara.

7.3.3.1. Rekomandimet e dhëna nga KLSH janë:

- AIDA të marrë masa që për periudhën në vijim, Raportet e Monitorimit të buxhetit të hartohen me një informacion të plotë dhe shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet nga plani fillestar në atë përfundimtar.
- Agjencia të marrë masat e nevojshme për hartimin e "Deklaratës për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm", në përputhje me ligjin nr. 10296 dt 08.07.2010.
- Agjencia të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Kodit të Brendshëm Etik.
- AIDA të përditësojë rregulloren e brendshme dhe ta përshtatë atë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe strukturën e miratuar nga bordi drejtues si dhe të bëjë vlerësimin vjetor të punës për çdo punonjës.
- Agjencia të marrë masat e nevojshme për hartimin e strategjisë dhe regjistrin për menaxhimin e riskut në zbatim të pikës 2 të ligjit nr. 10296, dt 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"
- Agjencia të marrë masat për ngritjen e GMS, ekipet për menaxhimin e programeve, të hartojë pyetësoin e vetëvlerësimit për komponentët MFK, si dhe të aktivizojë adresën zyrtare në internet.
- Drejtuesit e AIDA-s, sektori i financës duhet të rakordojnë me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara mbi baza mujore dhe vjetore.
- Në akt rakordimin me thesarin, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara. Tepricat e

llogarisë 520 dhe llogarisë 466 duhet të vërtetohen me akt-rakordim me thesarin.

- Të merren masa për plotësimin e pasqyrave financiare me shënimet shpjeguese. Shënimet të japin përshkrime me fjalë apo zbërthime të zërave të paraqitura në këto pasqyra, si dhe të evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes.
- AIDA të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.
- AIDA të marrë masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi.
- AIDA të marrë masat për analizimin e vlerës së origjinës së diferencës dalë nga auditimi i Pasqyrës Financiare të vitit 2018.
- AIDA të marrë masat që përpara raportimit të pasqyrave financiare të institucionit të bëjë rakordimin e gjendjes fizike me atë kontabël, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të saj.

7.3.3.2 Masat e marra për zbatimin e rekomandimeve.

- AIDA ka marrë masat duke hartuar raportin e monitorimit dhe dërguar atë në MFE "Dërgohet Raporti i Monitorimit për vitin 2019".
- Agjencia ka hartuar Kodin e Brendshëm Etik dhe me Urdhrin nr. 172 datë 18.12.2019 të Drejtorit Ekzekutiv, është bërë edhe miratimi i tij.
- AIDA ka realizuar vlerësimin e punonjësve për vitin 2019, si dhe ka hartuar draft-rregulloren e brendshme, ashtu edhe draft-statutin e ri të Agjencisë, me qëllim përshtatjen e tyre me strukturën e re organizative. Ka mbetur pa realizuar vetëm miratimi në bord, ku miratimi i saj do të jetë pjesë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës të Bordit Drejtues të agjencisë.
- AIDA me anë të vendimit të titullarit nr.5 dt 15.01.2020 "Për hartimin e strategjisë dhe menaxhimit të riskut për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve"; ka realizuar plotësisht hartimin e regjistrit të riskut.
- Ngritja e GMS dhe ekipet për menaxhimin

- e programeve realizohen nga MFE, me anë të Urdhrit nr. 185, dt 17.05.2019 "Për ngritjen e ekipeve të Menaxhimit të Programeve Buxhetore" ky ekip ka qënë i ngritur për vitin 2019, ndërsa për 2020 akoma nuk ka dalë urdhri nga MFE.
- Agjencia ka hartuar dhe raportuar në MFE pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët MFK si dhe adresa zyrtare e faqes së AIDA-s është aktive.
- Sektori i financës rakordon dhe raporton në mënyrë periodike (çdo muaj) me të tretët (furnitorët/klientët) ku është siguruar se shumatat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve (duke kontrolluar shumën dhe nr. e llogarisë nga faqja e MFE Pagesa të kryera nga drejtoria e thesarit) si dhe duke raportuar çdo muaj në MFE mbi detyrimet apo faturat e papaguara.
- Agjencia mori masa menjëherë duke shtuar në formatin e akt rakordimit me thesarin një kolonë e cila paraqet tepricat e llogarisë 520 dhe asaj 466. Ky lloj formati do të vijojë të përdoret në vazhdimësi.
- AIDA ngriti një grup pune, Urdhri nr.112/2. Prot., datë:16.12.2019 "Për ngritjen e Komisionit të Inventarizimit fizik dhe ekonomik të aseteve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", ku të gjithë anëtarët e komisionit nënshkruan formularin e konfliktit të interesit për të vërtetuar paanësinë e tyre.
- U hartua një regjistër i plotë në të cilin pasqyrohet ndryshimi i gjendjes së aktiveve, monitorimi fizik i tyre si dhe zhvlerësimi i këtyre aktiveve në bazë të amortizimit vjetor.
- Titullari i institucionit me anë të Urdhrit nr. 179 të datës 18.12.2019 , morri masa të menjëhershme ku ngarkoi nëpunësin zbatues për të sistemuar diferencën financiare të vitit ushtrimor 2018. Proces-verbali i mbajtur nga NZ shpjegon origjinën e kësaj difference.
- Agjencia jonë mori masa të menjëhershme në zbatim të urdhrit të titullarit nr.112/3 datë 19.12.2019 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik dhe kontabël të AIDA-s"; përpara raportimit të Pasqyrës Financiare të 2019-tës.

ANEKS 1

LISTA E INVESTITORËVE TË HUAJ MË TË FUQISHËM NË VEND

Nr.	Kompania	Sektori	Qarkullimi për 2018 (ALL)	Fitimi para tati- mit 2018 (ALL)	Numër te punësu- arish 2018	Vlere eksporti 2018 (ALL)
1	Vodafone Al- bania	Telekomu- nikacion	19,471,623,199	1,710,439,663	418	54,915,829
2	Albtelecom	Telekomu- nikacion	10,916,046,178	(4,720,737,000)	818	382,388
3	Telekom Alba- nia	Telekomu- nikacion		(329,742)		
4	IDS (Intercom Data Service)	Telekomu- nikacion	1,638,125,652	(196,736,228)	1,018	1,638,125,652
5	Abcom	Telekomu- nikacion		353,807,901		
6	ALEAT	ICT	2,389,540,094	505,746,224	301	59,971
7	DELOITTE AL- BANIA SH.P.K	Consultancy	-	78,219,314	217	-
8	Forschner Albania	Automotiv	503,293,761	(157,006,286)	747	30,942,656
9	COTEX Textile	Textile	742,152,514	9,732,868	383	741,924,967
10	DBS Group	Textile	525,334,892	48,994,733	463	509,421,510
11	DONIANNA	Footwear	1,845,493,929	33,036,754 (2017)	727	1,651,276,085
13	AMERICAN HOSPITAL	Medical Care	5,053,256,105	(203,480,000)	1,324	107,735
14	SIGAL UNIQA Group AUS- TRIA	Insurance	4,607,034,788	133,707,000	256	-
15	INTERSIG VI- ENNA INSUR- ANCE GROUP	Insurance	2,307,259,623	82,744,000	133	-
16	ANSIG	Insurance	1,265,205,680	(18,159,000)	117	-
17	ALPHA BANK	Banking	1,265,205,680	(910,884,000)	430	24,799
18	CREDINS BANK	Banking	15,447,703,273	683,532,000	870	7,038,555
19	NATIONAL COMMERCIAL BANK	Banking	45,977,950,995	8,719,656,000	965	6,401,466

Nr.	Kompania	Sektori	Qarkullimi për 2018 (ALL)	Fitimi para tati- mit 2018 (ALL)	Numër te punësu- arish 2018	Vlere eksporti 2018 (ALL)
20	OTP BANK	Banking	5,241,745,317	(599,563,250)	425	-
21	PROCREDIT BANK	Banking	2,560,837,658	723,394,427	166	3,628,595
22	RAIFFEISEN BANK	Banking	11,202,271,116	3,974,257,000	1,278	-
23	TIRANA BANK	Banking	3,059,894,800	(1,627,236,000)	433	-
24	UNITED BANK OF ALBANIA	Banking	337,286,732	30,791,000	76	-
25	GOLDEN EAGLE (Hotel Rogner)	Tourism	802,161,093	62,264	154	
26	intours alba- nia	Tourism	598,604,929	642,443	16	
27	Bankers Petro- leum	Energy	39,983,462,430	896,039	575	20,481,156,289
28	Shell Upstream Albania B.V	Energy	621,576,279	354,240	53	298,564,352
29	ENERGJI ASH- TA	Energy	2,380,906,645	1,525,144,256	23	
30	Balkan Green Energy	Energy	546,318,072	56,939,953	120	
31	Trans Adriatic Pipeline AG	Energy	6,130,662,957	159,334,030 (2017)	23	2,732,681
32	SPIECAPAG Transadriatica	Energy		1,485,990,352		
33	DEVOLL Hy- dropower	Energy	14,537,103,250	446,437,791	106	1,849,316,555
34	Weatherford Services LTD	Energy	767,081,785	55,970,172	23	4,076,664
35	Summer Drill- ing Services (ish-Simmons Edeco)	Energy	89,458,253	274,055,170	130	
36	SPIECAPAG Shqipëria	Infrastructure	40,623,131,567	1,395,507,759	22	1,442,859,182
37	JOINT VEN- TURE RENCO TERNA ALBA- NIA BRANCH	Infrastructure	12,645,485,118	941,072,725	73	12,615,557
38	BESSAC	Infrastructure	3,231,459,301	1,072,190,774	2	39,813,822

Nr.	Kompania	Sektori	Qarkullimi për 2018 (ALL)	Fitimi para tati- mit 2018 (ALL)	Numër te punësu- arish 2018	Vlere eksporti 2018 (ALL)
39	ALB TIEFBAU	Infrastructure	642,958,282	12,476,762	103	
40	Maccaferri Balkans	Infrastructure	1,107,733,392	2,342,771	93	939,434,110
41	SAIPEM S.p.a	Infrastructure	1,687,776,751	102,903,234	3	
42	KURUM Inter- national Sh.A	Mining	29,428,058,657	692,534,134	563	15,842,466,012
43	ALBCHROME	Mining	12,516,859,822	1,344,307	1,223	11,633,344,953
44	BERALB	Mining	453,334,472	(1,049,954)	31	434,589,192
45	Albanian Nick- el Group	Mining		49,405,224		
46	Tirana Interna- tional Airport	Transport	8,586,077,481	3,131,618,511	388	
47	ALBCONTROL	Transport	3,646,537,760	128,880,002	326	
48	Adria Ferries Agency	Transport	2,709,147,028	31,614,222	16	
49	Mediterrane- an Shipping Company Albania	Transport	1,521,297,352	286,831,625	28	
50	DURRES CON- TAINER TER- MINAL	Transport	1,211,306,780	67,405,791	80	
51	CMA CGM ALBANIA	Transport	236,186,859	58,632,673	13	

ANEKS 2

PROJEKTE KONKRETE TË TRAJTUARA ME LIGJIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Nr	Subjekti Aplikues/ Emri i Projektit		Sektori	Vlera/Pune simi	Afati i realizimit
1	Mane TCI "New Born"		Turizëm	€ 26,000,000 250 vende pune	13.03.20 20
2	Green Coast "Green Coast 1"		Turizëm	€ 52,500,000 250 vende pune	27.04.20 21
3	ALB PANEL NGR "Albpanel"		Bujqësi Industrial e	€ 15,000,000 300 vende pune	38 muaj nga data e fillimit pasi investimi nuk ka filluar ende

Përshkrimi	Vendodhja	Pronësia	Procedura	Status Aktual
Projekte të miratuara				
Kompleks turistik në S=187,000 m ² .	Hamallaj, Durrës	Privat	Procedure Asistuar me VKIS Nr. 1/15 datë 14.7.2016	Eshte realizuar afërsisht 95% e investimit.
Kompleks turistik në S=183,500 m ² .	Palasë, Himarë	Privat	Procedure e Veçante me VKIS Nr. 2/13 datë 14.7.2016	Eshte realizuar mbi 50% e investimit.
Projekti synon te perdore lende te pare kallamin dhe te prodhojë si produkt final panele MDE.	Libofshë, Fier dhe Rremas, Lushnje	Shtet	Procedurë e Asistuar me Vendim te KIS Nr. 7/1, datë 5.12.2016	Janar 2020, KIS miratoi një nryshim në vendimin për Albpanel për ndryshim zone.

4	Agrocon Albania "Agrocon"		Bujqësi	€ 5,832,000 120 vende pune	26.01.20 19
5	Concord Investment "Gone Perivol"		Turizëm	€ 32,500,000 200 vende pune	12.04.20 22
6	Concord Investment "San Pietro"		Turizëm	€ 88,000,000 250 vende pune	05.05.20 20
7	Boiken shpk "Kepi Merli"		Turizëm	€ 78,000,000 263 vende pune	

Ferme Bujqesore ne S=30 Ha.	Ngurre z e Vogel, Krutje, Lushnje	Shtet	Procedurë e Asistuar me Vendim te KIS Nr. 21/2, datë 20.12.2017	Eshte realizuar afërsisht 95% e investimit.
Kompleks Turistik	Palase, Himare	Privat	Procedurë e Asistuar miratuar me Vendim te KIS nr. 24/2, date 20.11.2017	Eshte realizuar afërsisht 20% e investimit.
Kompleks Turistik	Gjiri i Lalzit	Privat	Procedurë e Vecante miratuar me vendim te KIS Nr.25/2, date 20.12.2017	Eshte realizuar afërsisht 60% e investimit.
Eko Resort	Ksamil, Sarand e	Shtet (Subjekti person i stimulua r)	Subjekti aplikoi per Procedurë e Vecante. Me vendim et KIS nr. 27/2, date	Projekti ne proces zbatimi

8	XH&M Co "Delta Bay"		Turizëm	€ 22,700,000 107 vende pune		Ko Tu
9	Star Tek "Dhermi"		Turizëm	€ 12,140,000		Re Tu

			20.12.2017, u vendos nje afat 30 dite pune shtese per shqyrtim te metejshem nga MTM Miratuar me VKIS nr. 27/5 date 04.03.2019	
kompleks turistik	Palasë, Vlorë	Privat	Subjekti ka aplikuar per Procedurë e Asistuar. Me vendim te KIS Nr. 23/2, date 20.11.2017 u vendos qe duhet pritur vendimi i KKT	Subjekti nuk ri aplikoi tek AIDA
resort turistik	Dhermi	Shtet	Subjekti aplikoi per Procedure e	Projekti fillon zbatimin pasi te behet regjistrimi

				300 vende pune	
10	GPP Korca		Energji (TEC Korca)	€349,700,000 123 vende pune	3 vite nga data e fillimit të investimit, pasi aktualisht fillon degjesa publike per VSM

			Asistuar. Me Vendim te KIS nr. 28/2, date 20.12.2017 u dha nej afat shtese prej 30 dite pune per te plotesuar projektin me dokumentacion shtese nga ana e subjektit Miraturar VKIS nr. 2/3 date 02.09.2019	fillestar I zones
HEC Korça	Korçe	Shtet	Procedure e vecante miraturar me vendim te KIS Nr.30/4, date 14.02.2018	Subjektit i eshte refuzuar Deklarata Mjedisore nga MTM.

11	EUROCOL Ëhite Rocks		Turizem	6,800,000 Euro 81 vende pune	3 vite nga fillimi
12	Aquatiq Akuaponi – hidroponi		Bujqesi	5,1 mln Euro 50 vende pune	6 muaj nga data e fillimit te investimit
13	Agroiliria Planatacion shege, avokado, finger lime....		Bujqesi	6,627 mln Euro 115 vende pune	5 vite nga data e fillimit. Investimi k afilluar vetem ne 87 ha toke.
14	Yura Coperatio n Albania		Industri Automoti ve (Zonë me	6.459.000	2 vite

Resort Turistik	Dhermi , sip. 1.91 Ha	Privat	Procedure e asistuar, miratuar me VKIS nr.15/3, date 04.03.2019.	Projekti ne proces zbatimi
Akuaponi – hidroponi	Karava sta , Divjake 1,3 ha Kerkon 146 ha	Shtet	Procedure e asistuar Miratuar me Vendim KIS nr.4/4, date 19.04.2018	Subjekti ka riaplikuar per nje siperfaqe me te madhe, ne te njejten zone ku eshte mmiratuar edhe ndryshimi potencial per Albpanel
Planatacion shege, avokado, finger lime....	Karava sta, Divjake 500 ha	Shtet	Procedure e asistuar Miratuar me vendim KIS nr. nr.6/4, date 19.04.2018	Ne proces nenshkrimi i MGF ndermejt MFE dhe subjektit
Fabrike per prodhimin e pjeseve	Bazo e Tubove Fier	Shtet	Procedure e asistuar	Projekti ne proces zbatimi

			përparësi zhvillimi)			
15	Soleil & Sea		Turizem (Kompleks Turistik)	67,000,000 Euro	3 vite	
	Jala Entertainment Park			620 vende pune		
1	Adriatica Holding shpk		Bujqesi (nensektori akuakulture)	4,2 mln Euro	10 vite	
	Kultivimi i karakalecave			120 vende pune		

automotive			Miratur me VKIS nr 14/3 date 12.02.2019	
Resort Turistik	Jale – Vuno, Himare Siperfa qe 22 ha	Privat dhe Shtet	Miratur me VKIS Nr. 20/5, date 01/08/2019	Projekti ne proces zbatimi. Eshte pezulluar nje pjese e projektit per shkak te ceshtjeve te pronesise.
projekte të refuzuara				
Kultivimi i karakalecave	Karava sta , Divjake 400 ha	Shtet	Procedure e asistuar Refuzuar me Vendim KIS Nr. 1/3, date 19.04.2018	Projekti nuk u miratua pasi bazuar ne legjislacionin per mbrojtjen e mjedisit, atij per zonat e mbrojtura, legjislacionit per vleresimin e ndikimit ne mjedis, specia e perdorur ne kultivim eshte e ndaluar ne Evrope, si nje specie invazive qe shkakton zhdukjen e specieve autoktone.

2	South Coast Development KRORËZ RESORT		Investim Shqiptar + i Huaj.	Turizëm Hotel + Vila 110,000,000 euro Punësim 600 vende pune.	4 vite
2	Novosele Photovoltaic Power Plant Implant Fotovoltaik Energjitik 50 MëAC, Novosele		Energji	84.782.706 Euro Punësimi 503-784 vende	3 vite

Krorëz , Shën Vasil	Privat/Shtet -Shtet zonë e azhormuar 889,567m ² -Shtet zone e pa azhormuar 498,644m ² -Pronë private 936,666m ²	Shtet dhe privat	Procedure e vecante Refuzuar me VKIS nr. 13/5 date 4.03.2019	Kerkesa u refuzua sepse subjekti nuk permbushte kapacitetet financiare te kerkuara nga ligji.
Impliant gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike	Vlore	Shtet	Refuzuar me VKIS Nr. 34/2, date 14/02/2018	Realizimi i parkut fotovoltaik eshte ne mosperputhje me destinacionin e parashikuar ne Planin e Pergjithshem Vendor Vlore, pasi ne kete zone parashikohet ndertimi i nje aeroporti. Subjekti nuk disponon nje autorizim paraprak te

3	Mane TCI Vala Mare II		Turizëm	64,162,910 Euro 200 vende pune	6 vite

				vlefshem, per shkak te perfundimit te afatit te vlefshmerise 6 mujore te Autorizimit Paraprak (per vazhdim procedure) nga MEI. Subjekti nuk paraqiti asnje dokumentacion te kerkuar nga ligji, brenda afateve te autorizimit paraprak, te leshuar nga ministria pergjegjese per energjine, duke humbur automatikisht te drejten e fituar ne perfundim te afateve te percaktuara ne miratimin paraprak.
Struktura turistike Vila dhe apartamente	Durres	Privat	Refuzuar me VKIS Nr. 22/2, date 20/11/2017	Shkak i refuzimit, si mungese e strukturave akomoduese turistike ne projektin Vala Mare II, ne perputhje me legjislacionin e turizimit dhe te investimeve strategjike ne fuqi.

4	Concord Investment		Turizem	26,125,000 Euro	2 vite
	Saranda Marina Resort & Senior Housing				
5	Millenium International		Turizem	21,081,700 Euro	3 vite
	Porro Vlore			148 vende pune	

Kompleks turistik	Sarandë	Shtetërore	Refuzuar me VKIS Nr. 26/2, date 20/11/2017	Projekti është vlerësuar si i pamaturuar. Ky projekt është në mosperputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Sarandë, pasi kriteret teknike të PPV Sarandë parashikojnë që destinacioni i zonës është rekreacioni/rigjenerimi urban, dhe jo banim e resort që do të shndërrojnë zonën në territor privat me përdorim të kufizuar.
Kompleks turistik, në sipërfaqe 64 ha	Vlorë	Privat + shtet	Refuzuar me VKIS Nr. 10/3, date 05/12/2016	Projektit iu refuzua statusi, për shkakë që lidhen me verifikimin e kushteve të ardhshme, pasi legjislati i ri për zonat e mbrojtura, i cili do të rregullojë funksionimin e sistemit të zonave të brendshme për zhvillimin e turizmit, ishte në proces

6	Mabetex Group Divjaka Resort Albania		Turizem		
7	Adriatica Holding shpk Kultivimi i karakalecave		Bujqesi (nensektori akuakulture)	4 mln Euro 120 vende pune	

				hartimi.
	Divjake	Shtet	Refuzuar me VKIS Nr. 16/3 , DATË 4 / 3 /2019	Projekti u refuzua pasi tipologjia e projektit nuk është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe atë për zonat e mbrojtura, pasi projekti synon të shtrihet brenda Parkut Kombëtar Divjaka- Karavasta dhe prek Zonë Qendrore, Zonë Kreative dhe Zonë të Përdorimit Tradicional.
Kultivimi i karakalecave	Karavasta , Divjake 400 ha	Shtet	Procedure e asistuar Refuzuar me Vendim KIS Nr. 18/5, date 01.08.2019	Mospranimi i kërkesës, pasi në referencë të legjislacionit për zonat e mbrojtura, legjislacionit për mbrojtjen e biodiversitetit, legjislacionit për zhvillimin e akuakulturës, specia e kërkuar për t'u

--	--	--	--	--	--	--

				përdorur për kultivim është specie invazive dhe tipologjia e projektit nuk përputhet me kriteret e zonës. Subjekti propozues paraqet mungesë të burimeve dhe kapaciteteve financiare, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.
--	--	--	--	---



invest in Albania

